



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

# **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**Nr.68**

**2005**

**15 shtator**

### **P Ë R M B A J T J A**

Vendim i ERE  
nr.39, datë 30.8.2005

Për miratimin e kodit të funksionimit të shpërndarjes së  
energjisë elektrike.....

Faqe

2375

**VENDIM**  
**Nr. 39, datë 30.8.2005**

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË FUNKSIONIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa i, nenit 9, nenit 44, si dhe të nenit 55 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.8.2005, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Task-Forca, e ngritur për përgatitjen e Kodit të Funkcionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Kodit të Funkcionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. (Kodi bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**KODI I FUNKSIONIMIT TË SHPËRNDARJES**

**HYRJE**

Kodi i funksionimit të shpërndarjes (Kodi i Shpërndarjes) është pjesë e akteve nënligjore të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (LSE).

Kodi i shpërndarjes është një përmbledhje rregullash, normash, procedurash dhe kërkesash teknike për administruesit dhe përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes, të cilët ndërtojnë marrëdhëniet midis tyre duke u bazuar në këtë Kod.

Në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore të përcaktuara nga ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (LSE) Kodi i shpërndarjes është ndërtuar në katër kapituj:


1. Kapitulli I: Dispozita të përgjithshme, në këtë kapitull specifikohen çështje të përgjithshme teknike dhe procedurale.

2. Kapitulli II: Planifikimi, në këtë kapitull specifikohen kriteret dhe procedurat që do të zbatohen nga kompania(të) e shpërndarjes për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes.

3. Kapitulli III: Operimi, në këtë kapitull specifikohen kushtet nën të cilat kompania(të) e shpërndarjes do të operojë në sistemin e shpërndarjes.

4. Kapitulli IV: Lidhjet, në këtë kapitull specifikohen kushtet, kriteret dhe afatet kohore që duhet të plotësojnë përdoruesit për t’u lidhur me sistemin e shpërndarjes ose për t’i modifikuar lidhjet e tyre ekzistuese.

Figura nr.1 Kodi i Shpërndarjes në kuadrin e legjislacionit për sektorin elektroenergjetik:



## KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### 1. Çështje të përgjithshme

#### 1.1 Qëllimi

Qëllimi i Kodit të Shpërndarjes është të promovojë dhe të vendosë rregullat dhe kërkesat teknike minimale për lidhjen në rrjet dhe mbajtjen e stabilitetit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rrjetit, të detyrueshme këto për kompaninë (të) e shpërndarjes dhe përdoruesit e lidhur në rrjetin elektrik të shpërndarjes.

#### 1.2 Objektivat e Kodit janë:

- Vendosja e një kuadri rregullash dhe normash me qëllim për të siguruar hyrjen e palëve të treta në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Përcaktimi i përgjegjësive dhe detyrimeve për kompaninë(të) e shpërndarjes dhe për të gjithë përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Specifikimi i standardeve për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Vendosja e kërkesave teknike për lidhjen e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Përcaktimi i kërkesave për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Vendosja e kërkesave për shkëmbimin e informacionit ndërmjet kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes.

#### 1.3 Atributet dhe kompetencat e kompanisë(ve) së shpërndarjes

1. Rrjetet e shpërndarjes drejtohen nga kompania(të) e licencuar, që kryen veprimtari në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike në një territor të caktuar.

2. Kompania(të) e shpërndarjes siguron nga rrjeti i shpërndarjes për zonat që mbulohen:

- furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike të klientët tariforë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, me përjashtim të klientëve të kualifikuar;

- b) menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes;
- c) mirëmbajtjen e mjediseve dhe pajisjeve, në përputhje me kërkesat teknike;
- ç) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe të ndryshimit të kërkesës për energji elektrike në rajon ose në territor;
- d) shërbime të tjera për klientët, të nevojshme për të përmbushur detyrimet e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

#### 1.4 Përcaktimi i termave

Në Kodin e Shpërndarjes fjalët dhe shprehjet e përdorura do të kenë kuptimet si më poshtë:

Termi	Përcaktimi
AC	Rryma alternative
Aksesi në sistemin e shpërndarjes	E drejta e subjekteve të licencuara që gjenerojnë ose furnizojnë energjinë elektrike, si dhe e drejta e konsumatorëve të energjisë elektrike që të lidhen dhe të përdorin, sipas legjislacionit në fuqi, shërbimet e rrjetit të shpërndarjes.
Fuqia elektrike aktive (W)	Produkti i tensionit dhe i rrymës dhe kosinusit të këndit ndërmjet tyre. $P=(U \times I) \times \cos\phi$ Matet me njësinë vat (W) ose shumëzime standarde : 1000W = 1KW 1000KW = 1MW 1000MW = 1GW 1000GW = 1TW = 10 <sup>12</sup> W
Energjia elektrike aktive(MWh)	Energjia elektrike është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, duke qenë integrali i caktuar i fuqisë aktive me kufij kohorë. Matet me njësi vat-orë ose shumëzime standarde: 1000Wh = 1KWh 1000KWh = 1MWh 1000MWh = 1GWh 1000GWh = 1TWh = 10 <sup>12</sup> Wh
Fuqia elektrike reaktive (VAr)	Produkti i tensionit dhe i rrymës dhe sinusit të këndit të fazës ndërmjet tyre. $Q=(U \times I) \times \sin\phi$ , matet me njësinë volt – amper reaktiv (VAr) dhe shumëzime standarde 1000 VAr = 1kVAr 1000 kVAr = 1MVAr 1000MVAr = 1GVAr 1000GVAr = 1TVAr = 10 <sup>12</sup> VAr
Energjia elektrike reaktive (VArh)	Energjia elektrike reaktive është integrali i caktuar me kufij kohorë i fuqisë reaktive, matur në njësi me volt-amper reaktive-orë ose shumëzime standarde që është; 1000 VArh = 1 kVArh 1000 kVArh = 1MVArh 1000MVArh = 1GVArh 1000GVArh = 1TVArh = 10 <sup>12</sup> VArh
RAT Mbrojtja back-up (Rezervë)	Rregullimi automatik i tensionit Ai sistem mbrojtje që do të stakojë një çelës qarku ose mekanizma të tjerë që ndërpresin rrymën e gabuar në mungesë të operimit të mbrojtjes, të një sistemi tjetër mbrojtjeje.

Black Start (Ristartimi)	Procedura e nevojshme për të ristartuar një ndërprerje të pjesshme ose totale të sistemit elektroenergetik.
Pika e furnizimit nga sistemi i transmetimit	Një pikë lidhje mes sistemit të transmetimit dhe sistemit të shpërndarjes ose mes sistemit të transmetimit dhe një përdoruesi të lidhur direkt në sistemin e transmetimit.
Dispeçerimi	Operimi i sistemit elektroenergetik duke marrë parasysh programimin dhe ruajtjen e sigurisë operative dhe parametrave të cilësisë sipas kushteve teknike.
Çelësi i qarkut	Një pajisje mekanike kyçëse/çkyçëse e aftë të ndërpresë rrymat në kushte normale të qarkut, si dhe të përcjellë dhe të ndërpresë për një periudhë të caktuar kohe rrymën në kushte të veçanta anormale të qarkut, si ato të qarkut të shkurtër.
Komisionimi	Procesi përfundimtar i testimit të një pjese të sistemit të shpërndarjes para se ajo pjesë e sistemit të vihet në punë.
Marrëveshja e lidhjes	Një marrëveshje në mes KSH dhe çdo përdoruesi të sistemit të shpërndarjes që përmban tërësinë e kushteve për lidhjen në sistemin e shpërndarjes.
Leja teknike për lidhje	Dokument i lëshuar nga KSH që lejon lidhjen e aplikantit me sistemin e shpërndarjes.
Pikëlidhje	Pika fizike në të cilën instalimet e përdoruesit të sistemit të shpërndarjes lidhen me sistemin e shpërndarjes.
Klienti fundor (tarifor)	Klienti (konsumatori) që blen energji elektrike për përdorim vetjak.
Klienti (Konsumatori) i kualifikuar	Klienti (konsumatori) që ka të drejtë të zgjedhë, për nevojat e tij vetjake, furnizuesin e kualifikuar të energjisë elektrike.
DC	Rrymë e vazhduar.
Kërkesa	Nëse nuk jepet ndryshe, kërkesa e shprehur në MW ose MVA <sub>r</sub> e energjisë elektrike aktive dhe reaktive, respektivisht.
Ndarësi	Një mekanizëm që siguron në pozicion të hapur një shkëputje të dukshme të një qarku elektrik.
Gjeneruesi i lidhur me rrjetin e shpërndarjes	Centrale elektrike me njësi gjenerimi të lidhur direkt me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
Kompania (të) e shpërndarjes (KSH)	Është person juridik i licencuar për të kryer shpërndarjen e energjisë elektrike në një zonë të caktuar
Ngarkesat e çrregullta	Ngarkesa që kanë mundësi të krijojnë harmonika, luhajtje ose mungesë balance në sistem.
Tokëzimi	Një mënyrë për të siguruar një lidhje në mes përcjellësve dhe pajisjeve elektrike dhe tokës, nëpërmjet një pajisjeje tokëzimi.
Pajisja e tokëzimit	Një mjet për të siguruar lidhje në mes një përcjellësi ose një pajisjeje elektrike me tokën me fuqi dhe aftësi të mjaftueshme për qëllimin e caktuar.
Ngjarja	Një ndodhi e paplanifikuar që ndodh me sistemin elektroenergetik, që çon në prishjen e parametrave të operimit dhe të shërbimit në këtë sistem.
Kushtet e ngjarjes	Kushte operimi për një instalim të veçantë elektrik me një ose më shumë defekte që dëmtojnë operimin e sistemit të shpërndarjes ose ndërpresin furnizimin me energji elektrike.

Rryma e lidhjes së shkurtër	Rryma që qarkullon në një qark të shkurtër në një pikë të caktuar në sistemin elektroenergjetik dhe që mund të shprehet me kA.
Luhatja (Flicker)	Perceptimi në mënyrë vizuale i krijuar nga një luhatje e lehtë që reflektohet në ndriçim ose shpërndarja spektrale e të cilit luhatet me kalimin e kohës.
Centralet elektrike Autoprodhues Gjenerues (prodhues)	Është personi që prodhon energji elektrike, kryesisht për përdorim vetjak. Një person i licencuar për të kryer veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
Injektimi nga rrjeti i transmetimit Harmonikat	Kalimi i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes nga sistemi i transmetimit në pikat e lidhjes midis tyre. Rryma sinusoidale me frekuencë të njëjtë me shumëfishat numerik të frekuencës nominale.
Tensioni i lartë Tensioni i mesëm Tensioni i ulët IEC	Tensioni në nivelin nga 110 kV e lart. Tensioni në nivelin nga 35 kV deri në 1 kV. Tensioni në nivelin nën 1 kV. International Electrotechnical Commission (Komisioni Elektroteknik Ndërkombëtar).
I izoluar	I shkëputur nga pajisja shoqëruese nga një izolator ose nga një ndarje e përshtatshme fizike.
kVA Pika e matjes	Kilovolt-ampër Pika e matjes është vendi fizik ku është instaluar sistemi i matjes së energjisë elektrike dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike. Pika fizike e matjes përcaktohet plotësisht nga marrëveshjet ndërmjet palëve.
Frekuenca nominale	Numri i cikleve të rrymës alternative për sekondë e shprehur në Hertz në frekuencën në të cilën operon normalisht sistemi, 50 Hertz.
Operimi Kufijtë e pronësisë	Një veprim i planifikuar i kryer në sistemin e shpërndarjes. Kufijtë mes sistemit të shpërndarjes dhe pajisjeve në pronësi të përdoruesit.
Ndërprerjet e planifikuara	Janë ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike për shkak të mungesës së gjenerimit, mbingarkesës së elementeve të sistemit elektroenergjetik, përveçse kur është ndërprerje e detyruar, si dhe ndërprerjet për mirëmbajtjet e planifikuara.
Central elektrik	Një tërësi godinash me disa impiante të caktuara, të cilat kanë si destinacion bazë gjenerimin e energjisë elektrike.
Pika e përbashkët	Pika në sistemin e shpërndarjes që është elektrikisht më afër me pikën e lidhjes dhe, nga e cila lidhen ose mund të lidhen ngarkesa të klientëve të tjerë.
Mbrojtja	Masa për parandalimin e kushteve jo normale në sistemin elektroenergjetik, zbulimin e defekteve dhe aktivizimin e alarmeve dhe dhënies të sinjaleve, deri në shkëputjen e elementit të defektuar.
Fuqia e instaluar e centralit elektrik	Kapaciteti nominal i fuqisë aktive që mund të japë një central i energjisë elektrike, bazuar mbi dokumentacionin e prodhuesit (certifikatën e prodhuesit), i cili është shkruar në etiketën (pasaportën) përkatëse të prodhuesit.

Fuqia maksimale e centralit elektrik SCADA (Supervisory Control and Data Acquisition) Furnizuesi	Maksimumi i mundshëm i fuqisë që është në gjendje të japë centrali i energjisë elektrike në kushte të caktuara mekanike dhe elektrike të tij. Person i licencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit në fuqi.
Përdoruesi i sistemit të shpërndarjes (Përdoruesi-i përdorur sipas këtij kodi)	Furnizuesit, furnizuesit e kualifikuar, prodhuesit e pavarur të lidhur me rrjetin e shpërndarjes, konsumatorët tarifor dhe konsumatorët e kualifikuar të lidhur direkt me rrjetin e shpërndarjes, si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik që përfiton nga shërbimet e rrjetit të shpërndarjes.
Përdoruesi kryesor	Përdoruesit kryesorë janë: Gjeneruesit me fuqi të instaluar mbi 100 kW të lidhur drejtpërdrejt me sistemin e shpërndarjes, si dhe të gjithë klientët e lidhur në sistemin e shpërndarjes në tension të mesëm.
Luhatjet e tensionit	Një seri ndryshimesh të shpejta tensioni që mund të jetë e rregullt ose e çrregullt.
Sistemi i transmetimit	Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike është një tërësi linjash elektrike të tensionit të lartë (110 kV, 150 kV, 220 kV, 400 kV), transformatorësh elektrike ose çdo instalim tjetër, funksioni i të cilëve përfshin transmetimin e energjisë elektrike ose interkonjeksionin.
Kodi i shpërndarjes	Është tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të shoqërive të shpërndarjes për konsumatorët.
Sistemi i shpërndarjes	Sistemi i shpërndarjes përfshin zbarat, pajisjet kyçëse/çkyçëse dhe transformatorët në nënstacionet 110/35/20/10 kV, si dhe të gjitha elementet në nivel tensioni më të ulët se 110 kV në pronësi të kompanisë së shpërndarjes.
Shpërndarja	Është transporti i energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen te konsumatori fundor.
ERE	Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike.
KSH	Kompania(të) e shpërndarjes
OST sh.a.	Operatori i sistemit të transmetimit
Tregu i energjisë elektrike	Marrëveshje tregtare me shumicë ose pakicë për të shitur dhe blerë energji elektrike në sistemin elektroenergjetik me qëllim që të sigurohet një furnizim i qëndrueshëm për klientët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
Aplikimet për lidhje me sistemin e shpërndarjes	Dokumente të plotësuara nga përdoruesit e perspektivës që kërkojnë akses për lidhje me sistemin e shpërndarjes, ose nga përdoruesit ekzistues për të modifikuar lidhjen ekzistuese. Me qëllim që të marrë miratimin e kompanisë(ve) të shpërndarjes për lidhje, dokumentet përgatiten sipas dispozitave të këtij Kodi.
Urdhri operativ	Urdhër i detyrueshëm për njësinë pritëse që lëshohet nga qendra dispeçer sipas rregulloreve në fuqi. Urdhrat transmetohen me telefon, fonograme dhe fakse ose pas instalimit të sistemit SCADA nëpërmjet mesazheve dixhitale.

Veprimi operativ	Veprime nga njësia që merr urdhrin operativ të nxjerrë nga Qendra Kombëtare Dispeçer ose Qendra Rajonale Dispeçer, si dhe veprimet e programuara nga palët që ndikojnë në funksionimin e sistemit energjetik.
Ndërprerjet për shkak të defekteve në sistemin elektroenergjetik	Ndërprerje e furnizimit me energji elektrike për shkak të defekteve të elementeve të sistemit elektroenergjetik (si linjat, transformatorët e nënstacioneve, njësitë gjeneruese etj.).
Kurba e ngarkesës	Progresi i ngarkesës gjatë çdo ore (00 – 24 orë) për një ditë ose një periudhë tjetër për një element të veçantë.
Shpërndarësi i energjisë elektrike	Çdo person ose subjekt juridik që mban një licencë shpërndarjeje, sipas legjislacionit në fuqi, me një nivel tensioni më të ulët se 110 kV.
Licencë	Është autorizimi që i jepet një personi, sipas përcaktimeve në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
Mirëmbajtja	Procesi i të gjitha veprimeve teknike dhe organizative të kryera për elementet e sistemit elektroenergjetik gjatë periudhës së mirëmbajtjes me qëllim që të rikuperohen aftësitë e tyre përformuese për funksionet e planifikuara.
Normat	Standardet, kodet, rregullat, vendimet dhe dokumente të tjera normative të vendosur me ligje, akte nënligjore, rregullore, urdhëresa, dokumente të tjera zyrtare dhe kontrata.
Objektet e sektorit elektroenergjetik	Një tërësi facilitetesh, ndërtesash dhe pajisjesh të ndryshme të projektuara për të gjeneruar, transmetuar dhe shpërndarë energji elektrike.
Defektet	Defekti është një fenomen që ndodh për shkak të arsyeve të brendshme dhe të jashtme dhe shkakton deformimin e parametrave të energjisë elektrike ose ndërprerjen për një periudhë të caktuar kohe të një ose më shumë elementeve, që nga ana tjetër çojnë në ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.
Humbjet teknike të energjisë	Humbjet teknike të energjisë elektrike në një element rrjeti që janë të barabarta me diferencën mes energjisë elektrike të injektuar në element dhe energjisë elektrike që del nga elementi.
Prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike	Gjeneruesit e energjisë elektrike të ndarë nga sistemi elektroenergjetik që prodhojnë energji elektrike për përdorimin e tyre ose për shitje tek kliente të veçantë, ose për shitje në sistemin elektroenergjetik.
Rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike	Rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike në nivelet 110 kV, 220 kV, 400 kV që mundëson transmetimin e sasive të mëdha të energjisë në distanca të largëta.
Qarku i shkurtër	Qarku i shkurtër ndodh për shkak të dëmtimeve të ndryshme ose veprimeve të gabuara që lidhin elementet mes dy pikave me potenciale të ndryshme.
Sektori elektroenergjetik	Bashkësia e aktiviteteve të planifikimit, zhvillimit, ndërtimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes për instalimin e centraleve të gjenerimit, transmetimit, shpërndarjes, sistemeve/objekteve të klientëve të kualifikuar, furnizuesit e energjisë elektrike dhe linjat e interkonjeksionit për import-eksportin dhe shkëmbimet me vendet fqinje.

Procedurat për mosmarrëveshjet	Procedurë e përshkruar nga Kodi për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesve.
Palët	KSH dhe përdoruesit e sistemit të shpërndarjes
Aplikantët e sistemit të shpërndarjes	Person juridik, përdorues aktual ose i ardhshëm i sistemit të shpërndarjes që aplikon për leje për t'u lidhur ose për të modifikuar lidhjen ekzistuese në sistemin e shpërndarjes.
Stacioni (nënstacioni) transformues	Tërësia e faciliteteve elektrike, funksioni i të cilave është të transformojë dhe të transferojnë energji elektrike nga një rrjet në një rrjet tjetër me nivele të ndryshme tensioni.
Kyçja	Akti fizik i kyçjes së objekteve/sistemeve të përdoruesve me sistemin e shpërndarjes.
Njësia gjeneruese	Çdo njësi gjenerimi që gjeneron energji elektrike e lidhur me sistemin e shpërndarjes.
Faktori i fuqisë	Raporti i fuqisë elektrike aktive (W) me fuqinë elektrike të plotë (VA) ( $\cos\phi$ ). Vlera minimale e lejuar e $\cos\phi$ është 0.9 ( $\cos\phi - 0.9$ ).
Ngarkesa	Ngarkesë është tregues teknik që shpreh në MW pjesëmarrjen e një ose shumatorën e disa pajisjeve apo konsumatorëve të lidhur në rrjetin elektrik.
Ngarkesa pik (MW)	Maksimumi i vlerës së ngarkesës në MW i regjistruar brenda një periudhe kohore specifike.

#### 1.5 Administrimi i Kodit të shpërndarjes

- Kompania(të) e shpërndarjes është administrator i Kodit të shpërndarjes.
- KSH ka për detyrë të zbatojë Kodin e shpërndarjes.
- Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes kanë për detyrë të zbatojnë kërkesat e Kodit të Shpërndarjes.
- Përdoruesit i sigurojnë ksh të drejtën për hyrjen në objektet e tyre për shërbime dhe lehtësira të nevojshme në zbatim të përgjegjësive të KSH.
- Përdoruesit zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet e lëshuara nga ksh, të cilat kërkohen në zbatimin e Kodit të shpërndarjes.
- KSH-së i kërkohet që periodikisht të rishikojë zbatimin e Kodit të shpërndarjes. Për këtë krijohet një Komision i rishikimit të kodit të shpërndarjes. Asnjë rishikim ose modifikim i Kodit të Shpërndarjes nuk mund të bëhet pa u diskutuar në takimin e Komisionit të Rishikimit të Kodit të Shpërndarjes dhe pa u miratuar nga ERE.

##### 1.5.1 Komisioni i Rishikimit të Kodit të Shpërndarjes (KRKSH)

Komisioni do të drejtohet nga kompania(të) e shpërndarjes dhe do të ketë përbërjen e mëposhtme:

1. Kryetari emërohet nga kompania(të) e shpërndarjes.
  2. Sekretari emërohet nga kompania(të) e shpërndarjes.
  3. Një anëtar që përfaqëson të gjithë gjeneruesit e pavarur, që janë të lidhur direkt me rrjetin e shpërndarjes.
  4. Një anëtar i cili përfaqëson interesat e klientëve tariforë
  5. Një anëtar që përfaqëson OST sh.a.
  6. Një anëtar që përfaqëson të gjithë furnizuesit, përfshirë furnizuesit e kualifikuar.
  7. Një anëtar që përfaqëson klientët e kualifikuar.
- KSH, brenda 30 ditëve nga miratimi i këtij Kodi, autorizon kryetarin dhe sekretarin e KRKSH të informojnë zyrtarisht të gjithë anëtarët e Komisionit për takimin e parë të Komisionit, minimumi shtatë ditë-pune përpara datës së përcaktuar për mbledhjen e KRKSH.

- Çdo pjesëmarrës në KRKSH informon sekretarin e Komisionit për emrat dhe funksionin e përfaqësuesve të tyre në KRKSH jo më pak se tri ditë-pune përpara takimit të parë të KRKSH-së.

- KRKSH brenda 30 ditëve nga mbledhja e parë harton rregulloren e veprimtarisë së tij. KRKSH mblidhet një herë në tre muaj ose kur kërkohet nga një prej pjesëmarrësve të KRKSH.

- Vendimet e KRKSH-së merren me konsensus. Në rast të mosarritjes së konsensusit, të gjitha propozimet e bëra nga palët në KRKSH i dërgohen ERE-s, vendimi i së cilës është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjitha palët.

#### 1.5.2 Funksionet e Komisionit të Rishikimit të Kodit të Shpërndarjes (KRKSH)

Komisioni i Rishikimit të Kodit të Shpërndarjes duhet:

1. Të mbajë në një mbikëqyrje të vazhdueshme Kodin e Shpërndarjes dhe të marrë iniciativa për rishikimin e tij.

2. Të analizojë çdo defekt të rëndë në rrjetin e shpërndarjes, dhe mbështetur në këtë analizë të rishikojë në mënyrë të vazhdueshme Kodin e Shpërndarjes.

3. Të marrë në konsideratë të gjithë kërkesat për ndryshime të Kodit të Shpërndarjes, që propozohen nga palët, dhe t'ia paraqesë ERE-s për shqyrtim.

4. Të informojë palët mbi rekomandimet për ndryshime të Kodit të Shpërndarjes së bashku me arsyet për këto ndryshime dhe çdo kundërshtim nëse ka.

5. Të shqyrtojë problemet e ngritura nga përdoruesit.

#### 1.6 Mosmarrëveshjet

##### 1.6.1 Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet përdoruesve dhe KSH, mosmarrëveshja do të zgjidhet duke u bazuar në dispozitat e vendosura në këtë Kod dhe në legjislacionin në fuqi. Në rast mospërputhje ndërmjet dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE, kjo e fundit vendos për dispozitat që do të përdoren.

#### 1.7 Periudhat e emergjencës

Në periudhat e emergjencës të përcaktuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Kodi ose pjesë të veçanta të tij, do të trajtohen si përkohësisht të pezulluara për aq kohë sa zgjat emergjenca.

## KAPITULLI II PLANIFIKIMI

Kapitulli i planifikimit, specifikon kriteret dhe procedurat që do të zbatohen nga kompania(të) e shpërndarjes për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, dhe nga përdoruesit e këtij sistemi kur planifikojnë zhvillimin e instalimeve të tyre.

#### 2. Qëllimi

i) Planifikimi i zhvillimit të sistemit të shpërndarjes ka qëllimet e mëposhtme:

a) të hartojë planin e zhvillimit perspektiv të sistemit të shpërndarjes, për të qenë i aftë të shpërndajë energjinë elektrike në sasi dhe cilësi, të kërkuar prej përdoruesve;

b) të përcaktojë operimin e sistemit të shpërndarjes sipas kushteve të sigurisë, si dhe krijon garancitë për të lejuar shpërndarjen e energjisë elektrike në nivelet e kërkuara të cilësisë;

c) të orientojë dhe të nxisë investimet me efikasitet në sistemin e shpërndarjes, nëpërmjet inicimit të procedurave të nevojshme, si dhe mbledh e përpunon informacionin e nevojshëm për hartimin e planit të zhvillimit të sistemit.

ii) Zhvillimi dhe modernizimi i sistemit të shpërndarjes merr në konsideratë:

a) rritjen e kërkesës për energji elektrike;

b) zhvillimin dhe sistemimin e zonave rurale dhe urbane;

c) ndërtimin e pikave të reja ose modifikimi i atyre ekzistuese;

d) nevoja e përmirësimit të treguesve të performancës për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

## 2.1 Objektivat e planifikimit

Objektivat e planifikimit janë:

Të mundësojë që sistemi i shpërndarjes të planifikohet, projektohet dhe ndërtohet për të operuar në mënyrë ekonomike dhe të sigurt.

- Të mundësojë përdorimin (krijojë akses) e sistemit të shpërndarjes dhe nga përdorues të rinj që duan të lidhen në këtë sistem, duke specifikuar standarde furnizimi.

- Të sigurojë informacion të mjaftueshëm për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për të vlerësuar mundësitë për lidhje dhe për të planifikuar dhe zhvilluar instalimet e tyre në mënyrë që të përshtaten me sistemin e shpërndarjes.

- Të formalizojë kërkesat e të dhënave për planifikimin e sistemit të shpërndarjes.

- Hartimi i planit të zhvillimit për sistemin e shpërndarjes

2.2 Hartimi i planit të zhvillimit të sistemit të shpërndarjes bazohet në të dhënat e mëposhtme:

a) parashikimet e kërkesës për çdo vit të bëra nga furnizuesit (duke përfshirë kurbat e tipeve të ngarkesës për ditë të veçanta);

b) parashikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues (max. 10 vjet);

c) nivelin e sigurisë të përcaktuar në të gjithë sistemin e shpërndarjes dhe në secilën nyje të përshtatet me normat në fuqi;

d) strategjinë për zhvillimin e infrastrukturës së telekomunikacionit të kompanisë(ve) së shpërndarjes.

## 2.3 Kriteret e planifikimit

Plani i zhvillimit të sistemit të shpërndarjes do të përgatitet në bazë të studimit të zhvillimit perspektiv, për një kohëzgjatje mesatare 5-vjeçare dhe maksimale 10-vjeçare për rrjetin elektrik. Plani i zhvillimit të sistemit të shpërndarjes merr parasysh:

a) sigurinë, operimin e qëndrueshëm dhe zbatimin e standardeve për shërbimin cilësor të shpërndarjes së energjisë elektrike

b) përdorimin e kapaciteteve të sistemit të shpërndarjes në limitet ekonomike;

c) zgjedhjen e alternativës së zhvillimit me efikasitet maksimale ekonomike;

d) përcaktimin e operimit ekonomik të rrjetit shpërndarës në kushtet e ngarkesës së paqëndrueshme;

e) respektimin e normave të sigurisë, si dhe ligjet për ndalimin e zjarrit.

Planifikimi i zhvillimit të sistemit të shpërndarjes synon gjithashtu të kufizojë impaktin negativ të shkaktuar në mjedis, kryesisht nga:

i) ndotjet kimike;

ii) mjedisi agresiv (lagështira, ngricat e tepërta, akulli, kripërat, erërat e forta, ajri i turbullt në korrentet vertikale etj.);

iii) fatkeqësitë natyrore (tërmetet, përmbytjet);

iv) shkarkesat atmosferike.

### 2.3.1 Kriteret për verifikimin dimensional të sistemit të shpërndarjes

Verifikimi dimensional i sistemit të shpërndarjes do të kryhet konform normave teknike në fuqi, duke marrë parasysh 3 kriteret e mëposhtme për studim:

a) kriterin ekonomik;

b) kriterin e qëndrueshmërisë termike në operimin afatgjatë;

c) kriterin e qëndrueshmërisë termike dhe dinamike në rregjimin e lidhjes së shkurtër.

## 2.4 Planifikimi dhe zhvillimi i rrjetit

### 2.4.1 Parashikimet për pikën e lidhjes në rrjetin e shpërndarjes

Kompania(të) e shpërndarjes duhet t'i japë çdo përdoruesi të sistemit të shpërndarjes një njoftim me shkrim 30 ditë kalendarike para datës në të cilën përdoruesi i sistemit të shpërndarjes duhet t'i sigurojë kompanisë(ve) së shpërndarjes informacionin që kërkohet nga kompania(të) e shpërndarjes.

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes duhet t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes detajet për kapacitetin e ardhshëm të planifikuar, nëse KSH e ka kërkuar këtë informacion në procedurën e caktuar në Kodin e Shpërndarjes, si dhe informacione lidhur me kapacitetin e energjisë elektrike aktive dhe reaktive, datën e propozuar për fillimin, orët e operimit dhe kërkesat e veçanta të operimit. Çdo përdorues i sistemit të shpërndarjes duhet të sigurojë informacion të saktë, që duhet të përfshijë detaje të çdo faktori që mund të ndikojë mbi parashikimet e kapacitetit ose faciliteteve të parashikuara të gjenerimit.

Nëse KSH vlerëson ndonjë informacion ose parashikim si jo realist, KSH mund ta modifikojë informacionin ose parashikimin dhe duhet t'u japë një arsytim me shkrim përdoruesve të sistemit të shpërndarjes për këtë veprim dhe për arsyen e modifikimit. KSH nuk do të jetë përgjegjës për asnjë pasojë të dëmshme të këtij veprimi ose pasojave që mund të vijnë, nëse informacioni i treguar nuk modifikohet.

#### 2.4.2 Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes

KSH duhet të analizojë operimin e rrjetit të shpërndarjes gjatë një periudhe specifike planifikimi, duke marrë parasysh kapacitetet dhe ngarkesat e parashikuara, çdo zhvillim të ardhshëm të gjenerimit dhe transmetimit dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

KSH duhet të bashkëpunojë me operatorin e sistemit të transmetimit për të rishikuar planin vjetor të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes. Rishikimi vjetor i planifikimit duhet të përfshijë pikat e lidhjeve ekzistuese, si dhe propozimet për pikat e ardhshme të lidhjes. Çdo vit KSH duhet t'i sigurojë ERE-s planin e zhvillimit afatgjatë (mesatar 5-vjeçar dhe maksimal 10-vjeçar), që në vijim axhustohet bazuar në eksperiencat ndërkombëtare, zhvillimin e teknologjisë, ndryshimet e ekonomisë kombëtare dhe zhvillimit të saj. Çdo vit KSH duhet të përshtasë planin e saj afatgjatë të zhvillimit me planin e zhvillimit të sistemit të transmetimit të realizuar nga OST sh.a.

Nëse shërbimet e sistemit të shpërndarjes në një pikëlidhje ndikohen direkt nga rritja e ngarkesës së një përdoruesi, duhet negociuar mes palëve për amendimet e duhura të marrëveshjes (kontratës) së lidhjes dhe për vendosjen e kushteve të tjera në këtë pikëlidhje. Kur KSH bie dakord me gjeneruesin e lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes për ta përdorur atë periodikisht për të siguruar shërbimet ndihmëse të rrjetit, atëherë kostot e këtij shërbimi ndihmës të rrjetit duhen përfshirë në llogaritjen e shërbimit të shpërndarjes të përcaktuara në metodologjinë e tarifave të shpërndarjes. Në këtë rast, KSH ndërmerret sa më poshtë:

i) regjistron gjeneruesin e lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes dhe specifikon që gjeneruesi mund të përdoret periodikisht për të siguruar shërbimet ndihmëse të rrjetit të shpërndarjes;

ii) përfshin koston e këtij shërbimi ndihmës të rrjetit të shpërndarjes në llogaritjen e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në përputhje me metodologjinë e tarifave.

#### 2.4.3 Planifikimi i rrjetit të shpërndarjes

Planifikimi i rrjetit të shpërndarjes realizohet nga KSH duke u bazuar në kërkesat e përdoruesëve të lidhur me sistemin e shpërndarjes, si dhe në planifikimin e sistemit të transmetimit të realizuar nga OST sh.a. KSH dhe operatori i sistemit të transmetimit bashkëpunojnë për të plotësuar detyrimet e tyre lidhur me planifikimin e rrjeteve përkatës. KSH dhe operatori i sistemit të transmetimit, bazuar në vendime të marra së bashku, përballojnë së bashku kostot e studimeve të kërkuara për veprimet planifikuese.

#### 2.5 Standardet e planifikimit të sistemit të shpërndarjes

Standardet e planifikimit të sistemit të shpërndarjes u sigurojnë përdoruesve të sistemit të shpërndarjes informacionin që u nevojitet për të vendosur pajisjet në pikën e tyre të lidhjes me sistemin e shpërndarjes. Standardet e planifikimit të sistemit të shpërndarjes janë si vijon:

- Frekuenca e furnizimit ka vlerën e saj nominale (frekuenca nominale) 50 Hz. Duke pasur parasysh se frekuenca është një parametër kryesor për sigurinë e operimit të sistemit elektroenergjetik, kompania(të) e shpërndarjes do të instalojë në sistemin e saj shkarkimin automatik të ngarkesave nga ulja e frekuencës (SHAF). Struktura e operimit të SHAF hartohet nga OST sh.a. në bashkëpunim me kompaninë(të) e shpërndarjes.

- Kufiri normal i operimit: 49.8 deri 50.2 Hz.  
 - Gjatë çrregullimeve të sistemit: 48.0 deri 52.0 Hz.  
 Nivelet e tensionit në sistemin e shpërndarjes janë: 220 V, 380 V, 6Kv, 10 kV, 20 kV, 35 kV110 kV (pa përfshirë linjat 110kV).

Figura nr.2 – Kufijtë e tensionit gjatë operimit

Tensioni nominal	Tensioni më i lartë	Tensioni më i ulët
220 v	+ 10%	- 15%
380 v	+10%	- 15%
10 000 v	10 750 v	I variueshëm sipas kushteve të operimit
20 000 v	24 000 v	Informacion mbi vendndodhjen e veçantë sipas kërkesës së përdoruesit të interesuar
35 000 v	39 000 v	31 000 v
110 000 v	99 000 v	123 000 v

## 2.6 Kërkesat për gjeneruesit e pavarur të lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes

Kodi i Shpërndarjes aplikohet për gjithë gjeneruesit e pavarur ekzistues ose të ardhshëm të lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes, përfshirë gjeneruesit me koogjenerim, gjeneruesit me vetëprodhim, si dhe gjeneruesit që përdorin burime të rinovueshme të energjisë elektrike.

Gjeneruesit me gjeneratorë “stand-by”( në gatishmëri) që janë të lidhur me sistemin e shpërndarjes, duhet të plotësojnë kërkesat e kompanisë(ve) së shpërndarjes duke shmangur operimin në paralel me rrjetin. Këto kërkesa përshkruhen në marrëveshjen e lidhjes. Gjeneruesit e lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes do të nisin diskutimet në një stad të hershëm të planifikimit, për të lejuar kompaninë(të) e shpërndarjes që të shqyrtojë ndikimin e njësisë gjeneruese mbi sistemin e shpërndarjes.

Kompania(të) e shpërndarjes mund të refuzojë lejen për lidhjen e njësisë gjeneruese në një pikë të sistemit të shpërndarjes ose të kërkojë rishikim të parametrave të ndërtimit ose parametrave teknike të njësisë gjeneruese, ose të vendosë disa kufizime me qëllim që të garantojë ruajtjen e sigurisë dhe cilësinë e standardeve të furnizimit. Në këtë rast, KSH do të sigurojë informacion të mjaftueshëm shpjegues për të justifikuar refuzimin ose rishikimet e kërkuara. Të gjithë gjeneruesit e lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes do t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes të gjitha të dhënat dhe informacionin e kërkuar nga KSH sipas afateve të përcaktuara në këtë Kod.

2.6.1 Të dhëna që kërkohen nga të gjithë konsumatorët, përfshi dhe konsumatorët e kualifikuar të lidhur me sistemin e shpërndarjes.

Konsumatorët e lidhur me sistemin e shpërndarjes do t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes të dhënat e mëposhtme, si dhe të gjitha të dhënat dhe informacionin e kërkuar nga KSH sipas afateve të përcaktuara në këtë Kod:

1. Kërkesën për energji elektrike aktive vjetore.
2. Kërkesën për energji elektrike reaktive vjetore.
3. Kërkesën për energji elektrike maksimale vjetore.
4. Ngarkesën maksimale për çdo fazë.
5. Profilin e ngarkesës, ditët e pikut.
6. Tensionin nominal të pikës ku furnizohet ngarkesa.
7. Ndjeshmëria e ngarkesës nga tensioni dhe frekuenca.

### 2.6. 2 Transferimi i të dhënave të planifikimit

Kompania(të) e shpërndarjes në bashkëpunim me operatorin e sistemit të transmetimit vendos për kohën e periudhave të planifikimit dhe të dhënat e nevojshme që do të sigurohen për efekt planifikimi.

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes do të sigurojnë, me kërkesën e kompanisë(ve) së shpërndarjes, informacion si më poshtë, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga KSH:

- Rritjen/rënien e ngarkesës dhe kërkesës gjatë periudhës së ardhshme të planifikimit.
- Aftësinë për të marrë pjesë në prodhimin ose kompensimin e energjisë elektrike reaktive.
- Mungesën ose prezencën e ngarkesave të çrregullta.
- Energjinë që do tregtohet dhe adresat e furnizuesve në rast se përdoruesit e sistemit të shpërndarjes janë furnizues/tregtare pa asete shpërndarjeje.

Gjeneruesit, e lidhur me sistemin e shpërndarjes, do të sigurojnë, me kërkesën e kompanisë(ve) të shpërndarjes, informacion si më poshtë, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga KSH:

- Informacion të përgjithshëm mbi gjendjen e tyre fizike.
- Parashikimet e kërkesës në rast të koogjenerimit.
- Parashikimet maksimale/minimale të kapacitetit.
- Parashikimet e prodhimit.
- Aftësitë për gjenerimin e energjisë elektrike reaktive.
- Si dhe të dhëna të tjera të kërkuara nga kompania(të) e shpërndarjes.

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes do të sigurojnë të dhëna planifikimi për periudha të veçanta kohore të ardhshme të plotësuar çdo vit sipas nevojave dhe që përfshijnë parashikimin e kërkesës, ndryshimet e pritshme në kërkesën maksimale ose në kapacitetin gjenerues.

Përveç përmirësimeve periodike të informacionit të planifikimit, përdoruesit e sistemit të shpërndarjes do të japin njoftimin e duhur për çdo ndryshim të rëndësishëm në sistemin e tyre, ose në regjimin e operimit për të mundësuar kompaninë(të) e shpërndarjes të përgatisin planet e tyre të zhvillimit dhe të zbatojë çdo modifikim të nevojshëm të sistemit të shpërndarjes. Në rast të ndryshimeve të paplanifikuara në sistemin e përdoruesit ose në regjimin e operimit, përdoruesi i sistemit të shpërndarjes do të njoftojë kompaninë(të) e shpërndarjes, sa më shpejt të jetë e mundur për të marrë masat e nevojshme që mund të zbatohen. Përdoruesit gjithashtu do të japin detaje për centralet për kompensim reaktiv, të lidhur direkt ose indirekt me sistemin e shpërndarjes, përfshirë dhe vlerësimin për kontrollin operativ.

Përdoruesve mund t'u kërkohej t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes të dhëna të detajuara lidhur me shkëmbimet në mes instalimeve të tyre dhe sistemit të shpërndarjes, që përfshijnë parametrat e qarkut, pajisjet e kyçes dhe të mbrojtjes për pajisjet e lidhura direkt ose që ndikojnë në sistemin e shpërndarjes, për t'i mundësuar kompanisë(ve) së shpërndarjes që të vlerësojnë ndikimet që shoqërojnë këto pika lidhjeje.

### 2.6.3 Informacioni që do të shkëmbehet

Me kërkesën e përdoruesit të sistemit të shpërndarjes, kompania(të) e shpërndarjes do të sigurojë informacion dhe të dhëna, siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyetuar nga përdoruesit e shpërndarjes. Në rastet kur kompania(të) e shpërndarjes në mënyrë të arsyetuar vlerëson se informacioni ose të dhënat e kërkuara nga përdoruesi i sistemit të shpërndarjes mund të dëmtojnë biznesin e kompanisë(ve) të shpërndarjes, ose përdoruesve të tjerë të sistemit të shpërndarjes, atëherë kompania(të) e shpërndarjes refuzon dhënien e një informacioni apo të dhënave të tilla.

Kompania(të) e shpërndarjes do të sigurojë informacion me kërkesë të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, lidhur me kushtet e rrjetit lokal për t'i mundësuar ata që të përcaktojnë kërkesat e tyre të mbrojtjes dhe të vlerësojnë nevojën për facilitete rezerve.

Kur instalimi i përdoruesit është i lidhur me zbarat e nënstacionit të sistemit të shpërndarjes, duhet të shkëmbehen të dhëna të detajuara të mjaftueshme lidhur me përdoruesin e sistemit të shpërndarjes/kufijtë e pronësisë së kompanisë(ve) së shpërndarjes, për të mundësuar bërjen e një vlerësimi mbi efektet e mbitensioneve. Kërkesa për informacion mund të nisët nga kompania(të) e shpërndarjes ose përdoruesi i sistemit të shpërndarjes.

Informacioni në mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesit të sistemit të shpërndarjes mund të shkëmbehet edhe për nivelin e rrymës së lidhjes së shkurtër në zbarën ushqyese ose në pikën e lidhjes me sistemin e shpërndarjes në formën e:

- Rrymës së lidhjes së shkurtër një ose tre fazore.

- Raportit X/R në kushtet e lidhjes së shkurtër trefazore (ku X reaktanca induktive dhe R rezistenca aktive).

Ndërmjet kompanisë (ve) së shpërndarjes dhe përdoruesit të sistemit të shpërndarjes do të shkëmbehet informacion mbi kapacitetin për transferimin e kërkesës, ku e njëjta kërkesë mund të furnizohet nga pika alternative furnizimi të përdoruesit. Kjo do të përfshijë pjesën e kërkesës që ushqehet normalisht nga çdo pikë furnizimi dhe rregullimet (manuale ose automatike) për transferim në kushtet e ndërprerjes së planifikuar/për shkak defektesh.

#### 2.6.4 Studimet e planifikimit

Me qëllim që të lehtësohen lidhjet e reja/modifikimet e lidhjeve ekzistuese me sistemin e shpërndarjes, kompania(të) e shpërndarjes do të përgatisë, sipas kërkesës, një studim që tregon ndikimet e lidhjes/ modifikimit në atë pjesë të sistemit të shpërndarjes. Kompania(të) e shpërndarjes mund të caktojë një pagesë të arsyeshme për studimin e planifikimit, bazuar në koston e studimit.

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes ose përdoruesit perspektivë të sistemit të shpërndarjes do të sigurojnë informacion për kompaninë(të) e shpërndarjes lidhur me facilitetet e propozuara përfshirë detajet e ngarkesës, marrëveshjet e shkëmbimit, pikat e propozuara të lidhjes dhe tërheqjen/injektimin për nevojat e sistemit të shpërndarjes.

Studimet do të përgatiten brenda 45 ditëve pas datës së kryerjes së pagesës, ose firmosjes së marrëveshjes nga personi që bën kërkesën për të paguar koston e studimit. Në rast të gjeneruesve dhe klientëve të kualifikuar që kërkojnë të lidhen me sistemin e shpërndarjes, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të kërkesës, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 100 ditë.

Detajet e procedurave për aplikimin për lidhje në sistemin e shpërndarjes janë përshkruar në pjesën e kapitullit të lidhjeve të këtij Kodi Shpërndarjeje. Kompania(të) e shpërndarjes do të sigurojë, sipas kërkesës, një raport mbi kapacitetet aktuale dhe të ardhshme të sistemit të shpërndarjes, parashikime të fluksit të energjisë dhe ngarkesat në pjesë të sistemit të shpërndarjes të specifikuara në kërkesë, si dhe do të përfshijë nivelet e gabimit në çdo nyje shpërndarje që mbulohet nga kërkesa. Kompania(të) e shpërndarjes mund të caktojë një pagesë për sigurimin e këtij raporti për të mbuluar kostot e arsyeshme të kryera nga kompania e shpërndarjes për përgatitjen e tij. Raporti do të përgatitet brenda 45 ditëve kalendarike. Në rastet e gjeneruesve të lidhur me sistemin e shpërndarjes dhe klientëve të kualifikuar që kërkojnë të lidhen, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 60 ditë në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të kërkesës.

## KAPITULLI III OPERIMI

Kapitulli i operimit specifikon kushtet në të cilat kompania(të) e shpërndarjes do të operojë me sistemin e shpërndarjes.

### 3. Parashikimi i kërkesës

Me qëllim që kompania(të) e shpërndarjes të operojë në mënyrë efçente sistemin e shpërndarjes dhe të realizojë siguri maksimale dhe qëndrueshmëri të sistemit të shpërndarjes, nevojitet që përdoruesit e sistemit të shpërndarjes t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes informacion mbi ngarkesën dhe sasinë e gjenerimit.

Kapitulli i operimit në kodin e shpërndarjes specifikon informacionin që do t'i sigurohet kompanisë(ve) së shpërndarjes nga përdoruesit e sistemit të shpërndarjes në mënyrë që të plotësohen kërkesat e mëposhtme:

- Informacioni që do të sigurohet duhet t'i mundësojë kompanisë(ve) së shpërndarjes ruajtjen e integritetit të sistemit të shpërndarjes.

- Të dhënat për kërkesën e përdoruesit të sistemit të shpërndarjes, do të thotë sasia në MW-orë për energji elektrike që kërkohet në pikën e lidhjes. Kompania(të) e shpërndarjes në disa raste mund të specifikojë që të dhënat e kërkesës do të përfshijnë dhe kërkesën në MVAR.

- Mjetet për sigurimin e informacionit për KSH-në dhe konfirmimi i tij përfshijnë çdo formë me shkrim ose çdo mjet tjetër të përshtatshëm të transferimit elektronik që e mundëson marrësin të marrë dhe të mbajë informacionin.

Kërkesat e dispozitave të mësipërme aplikohen për të gjithë përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes

### 3.1 Fluksi dhe koordinimi i informacionit

Kompania(të) e shpërndarjes do të koordinojë informacionin për parashikimin e kërkesës për çdo pikë lidhjeje me sistemin e transmetimit për të plotësuar kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit.

Informacioni për gjeneruesit e lidhur në sistemin e shpërndarjes që nuk janë objekt i dispeçerimit qendror do të sigurohet direkt për KSH-në. Njësitë gjeneruese të dispeçeruara në mënyrë qendrore (nga dispeçeria qendrore e sistemit elektroenergjetik) do të plotësojnë kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit. Informacioni do të sigurohet direkt për operatorin e sistemit të transmetimit.

### 3.2 Të dhënat për parashikimin e kërkesës

Njësitë gjeneruese me fuqi të instaluar më të madhe se 1 MW dhe që nuk janë objekt i dispeçerimit qendror do t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes informacion lidhur me prodhimin e tyre dhe ndërprerjet e planifikuara për periudha të ardhshme specifike. Kjo do të sigurohet në bazë vjetore kur kërkohet nga kompania(të) e shpërndarjes. Informacioni i kërkuar jepet në tabelën e mëposhtme:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6
Prodhimi maksimal i fuqisë aktive MW (vjetor orar)						
Prodhimi MW-orë						
Periudhat e planifikuara të ndërprerjes:						
-koha e nisjes së ndërprerjes						
- koha e përfundimit të ndërprerjes						

Përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes do t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes informacion lidhur me kërkesën dhe ndërprerjet e planifikuara për periudha të ardhshme specifike. Kjo do të sigurohet në bazë vjetore kur kërkohet nga kompania(të) e shpërndarjes. Informacioni i kërkuar jepet në tabelën e mëposhtme:

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6
Kërkesa maksimale për fuqi aktive MW						
Faktori i fuqisë (cos φ)						
Kërkesa vjetore për energji MWh						
Periudhat e planifikuara të ndërprerjes:						
- koha e nisjes së ndërprerjes						
- koha e përfundimit të ndërprerjes						

### 3.3 Planifikimi operativ

Pjesë e këtij Kodi është dhe koordinimi i ndërprerjeve të planifikuara të centralit ose instalimeve të përdoruesit që ndikojnë në operimin e sistemit të shpërndarjes.

Kodi i shpërndarjes parashton detyrimin e kompanisë(ve) së shpërndarjes për të siguruar informacion për operatorin e sistemit të transmetimit në përputhje me kodin e sistemit të transmetimit dhe vendos procedura për të mundësuar mbledhjen e këtyre të dhënave nga përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

Kërkesat për sigurimin e informacionit të caktuara në kodin e sistemit të transmetimit, që do të sigurohen nga operatori i sistemit të transmetimit, do të përbëjnë bazat e planifikimit operativ.

i) Objektivat e planifikimit operativ janë:

- Të vendosë për tërësinë e rregullave kur një central elektrik (i lidhur në rrjetin e shpërndarjes) do të ndërpresë punën e tij, të kërkuar nga vetë gjeneruesi apo të kërkuar nga sistemi i shpërndarjes.

- Të specifikojë informacionin që do të sigurohet nga përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për kompaninë (të) e shpërndarjes për ta lejuar të respektojë kodin e sistemit të transmetimit.

- Planifikimi operativ aplikohet për të gjithë përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes.

Informacioni mbi centralet e lidhura me sistemin e shpërndarjes që nuk janë objekt i dispeçerimit qendror (përfshirë gjeneruesit me koogjenerim dhe me vetëprodhim) do t'i sigurohet drejtpërdrejt kompanisë(ve) së shpërndarjes.

Njësitë gjeneruese që dispeçerohen nga dispeçeria qendrore do të plotësojnë kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit. Informacioni do t'i sigurohet drejtpërdrejt operatorit të sistemit të transmetimit.

ii) Afatet kohore dhe të dhënat:

Mbledhja e të dhënave dhe afatet kohore do të përcaktohen nga kompania(të) e shpërndarjes për çdo përdorues të sistemit të shpërndarjes.

3.4 Informacioni mund të kërkohej për periudha kohore të ndryshme siç mund të përcaktohet nga operatori i sistemit të transmetimit ose nga nevojat e planifikimit të kompanisë të shpërndarjes.

3.4.1 Informacioni nga gjeneruesit e lidhur me sistemin e shpërndarjes:

Informacioni nga centralet fikse gjeneruese më të mëdha se 1 MW dhe që nuk janë objekt i dispeçerimit qendror do të përfshijnë detaje të ndërprerjeve të planifikuara për mirëmbajtje ose për qëllime të tjera si dhe kohën e parashikuar të rikthimit në shërbim.

Gjeneruesi nuk do të sinkronizohet pa marrë më parë lejen operuese nga kompania(të) e shpërndarjes përveçse kur është arritur më parë një marrëveshje me kompaninë e shpërndarjes.

Informacion për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes

Kompania (të) e shpërndarjes do të informojë të gjithë klientët ose gjeneruesit që mund të ndikohen nga ndërprerjet e veçanta të sistemit të shpërndarjes, për datat dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve.

Nëse ka kundërshtime nga përdoruesit, ata do të merren në konsideratë nga kompania (të) e shpërndarjes dhe, nëse është e mundur, do të propozohen rregullime alternative.

3.5 Kontrolli i ngarkesës

Kodi i shpërndarjes i lejon kompanisë(ve) së shpërndarjes që në disa rrethana të aplikojnë reduktimet e ngarkesës, në rast të gjenerimit të pamjaftueshëm në sistemin elektroenergjetik dhe të kapaciteteve të pamjaftueshme transmetuese të linjave të interkonjeksionit me jashtë që janë të disponueshme për të plotësuar kërkesën, ose në rast të defekteve dhe/ose problemeve të operimit (si lidhur me frekuencën e sistemit, nivelet e tensionit të sistemit ose mbingarkesat termike të sistemit) ose të çdo pjese të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes.

Procedurat për kontrollin e ngarkesës sigurojnë minimizimin e vështirësive të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes dhe trajtimin e njëjtë të të gjitha palëve të prekura.

Termi “kontroll i ngarkesës” përdoret për të përshkruar secilën ose të gjitha këto mënyra për arritjen e reduktimit të kërkesës.

Kodi i shpërndarjes përcakton mënyrat e mëposhtme për reduktimin e ngarkesës:

- Shkëputja automatike e ngarkesës nga ulja e frekuencës;

- Reduktimi manual i ngarkesës së përdoruesit të sistemit të shpërndarjes;
- Reduktimi manual i ngarkesës së përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, sipas udhëzimeve të operatorit të sistemit të transmetimit ose kompanisë(ve) së shpërndarjes;
- Shkëputja manuale në rastet emergjente të ngarkesës.

Reduktimi i ngarkesës nga kompania(të) e shpërndarjes do të bëhet në një mënyrë që praktikisht të mos diskriminohet asnjë përdorues i sistemit të shpërndarjes (klient ose furnizues), si dhe do të bëhen përpjekje të arsyeshme për të siguruar që barra të ndahet në mënyrë të drejtë mes klientëve.

Kompania (të) e shpërndarjes, sipas udhëzimit të operatorit të sistemit të transmetimit ose për të arritur reduktimin e ngarkesës që do të shmangë ose lehtësojë problemet e operimit në sistemin e transmetimit dhe/ose sistemin e shpërndarjes, duhet të operojë në mënyrë që të mos diskriminojë asnjë furnizues ose klient të saj.

Zbatimi i kontrollit të ngarkesës nga kompania (të) e shpërndarjes mund të ndikojë mbi të gjithë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes (klientët e furnizuesit) të lidhur me sistemin e shpërndarjes dhe aty ku është e aplikueshme, duhet të reflektohet në marrëveshjen kontraktuale mes furnizuesve dhe klientëve të tyre.

#### 3.5.1 Metodat e kontrollit të ngarkesës

Ngarkesa në sistemin e shpërndarjes mund të shkëputet automatikisht në vende të zgjedhura në përputhje me kërkesat e kodit të rrjetit të transmetimit, në rast të rënies së menjëhershme të frekuencës. Një marrëveshje e tillë do të koordinohet me kujdes si pjesë e një skeme të përgjithshme dhe mund të marrë parasysh çdo kërkesë operative ose ngarkesë esenciale.

Shkëputja automatike nëpërmjet releve të frekuencës mund të përdoret për të shkëputur në mënyrë jodiskriminuese ngarkesën, në mënyrë që të mbahet frekuenca brenda kufijve të pranueshëm, në mënyrë që të shmanget një kufizim i madh i ngarkesës ose black-out.

Reduktimi manual emergjent i ngarkesës mund të kryhet në sistemet e shpërndarjes për arsye të mungesës së furnizimit ose për arsye të tjera të përcaktuara në këtë Kod.

Operatori i sistemit të transmetimit dhe kompania(të) e shpërndarjes mund të vendosin që më parë për grafikët e reduktimit të ngarkesës dhe të vendosin rradhën dhe sasinë e ngarkesës që do të shkëputet.

Grafikët e shkëputjes së miratuar nga operatori i sistemit të transmetimit duhet të jenë në dispozicion të çdo njësie operuese të kompanisë(ve) së shpërndarjes që kryen operimet e reduktimit të ngarkesës.

Në rast të periudhave të gjata të mungesës së energjisë mund të përdoren reduktime të njëpasnjëshme të planifikuara të ngarkesës për ta ndarë energjinë e disponueshme mes përdoruesve të prekur të sistemit të shpërndarjes (klientëve). Në këto rrethana KSH do të njoftojë të gjithë përdoruesit nëpërmjet mjeteve të informimit publik për territorin e ndërprerjes, si dhe për kohëzgjatjen e saj.

#### 3.5.2 Zbatimi i kontrollit të ngarkesës

Kur kontrolli i ngarkesës ushtrohet nga kompania(të) e shpërndarjes për të ruajtur sistemin e shpërndarjes, si dhe me kërkesë të OST-së për të ruajtur të gjithë sistemin elektroenergjetik, KSH duhet t'i përgjigjet këtyre kërkesave menjëherë, si dhe do të informojë përdoruesit e tjerë të sistemit të shpërndarjes aq sa është e mundur.

#### 3.5.3 Komunikimet dhe konsultimet operative

Kodi i shpërndarjes vendos kërkesat për shkëmbimin e informacionit lidhur me operimin dhe/ose ngjarjet në sistemin e shpërndarjes, ose instalimin e çdo përdoruesi të lidhur me sistemin e shpërndarjes që shkakton ndikim operativ në sistemin e shpërndarjes ose në instalimet e përdoruesve të tjerë të sistemit të shpërndarjes.

Kërkesat e Kodit të Shpërndarjes për shkëmbimin e informacionit lidhur me operimin dhe/ose ngjarjet në sistemin e shpërndarjes aplikohen për të gjithë përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes:

Kompania(të) e shpërndarjes dhe përdoruesit kryesorë të lidhur me sistemin e shpërndarjes do të caktojnë persona dhe/ose vende kontakti dhe do të vendosin kanale komunikimi për shkëmbimin e nevojshëm të informacionit të kërkuar.

Pajisjet SCADA mund të kërkojnë të instalohen në vendndodhjen e përdoruesit kryesor (në gjykimin e KSH-së) për transmetimin e informacionit dhe të dhënave nga dhe të kompania(të) e shpërndarjes ose dispeçeria qendrore. Kërkesat për sigurimin e këtij informacioni do të përfshihen në marrëveshjen e lidhjes.

Informacioni mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes do të shkëmbehet me kërkesën e arsyeshme të palëve. Kërkesa mund të jetë në përputhje me një marrëveshje të mëparshme për shkëmbim informacioni për arsye të ndryshme. Kjo nuk ndalon shkëmbimin vullnetar të informacionit që mund të mendohet si një pjesë e rëndësishme për operimin e sistemit të shpërndarjes ose instalimet e përdoruesve.

Në rast të veprimeve operative në sistemin e shpërndarjes ose pas njoftimit për veprim operativ në sistemin e transmetimit, që sipas mendimit të kompanisë (ve) të shpërndarjes do të ketë efekt operativ mbi instalimin e përdoruesit të lidhur me sistemin e shpërndarjes, kompania(të) e shpërndarjes do të njoftojë përdoruesin nëpërmjet mjeteve të informimit publik.

### 3.6 Menaxhimi i rrjetit të shpërndarjes ndërmjet dispeçerisë

#### 3.6.1 Të përgjithshme

Menaxhimi i sistemit të shpërndarjes nëpërmjet dispeçerisë është një aktivitet specifik në fushën e energjisë elektrike, kryer nga njësi të specializuara (funksione/nivele të dispeçerisë) që kanë marrëdhënie hierarkike të autoriteteve në pjesëmarrjen e tregut të energjisë elektrike.

Menaxhimi i sistemit të shpërndarjes i propozuar nëpërmjet dispeçerisë është kusht për operim në kushtet e sigurisë, cilësisë dhe atyre ekonomike nëpërmjet operimit bashkëpunues të instalimeve dhe komponentëve të pajisjeve të sistemit të shpërndarjes që kërkojnë një menaxhim unik.

Menaxhimi i sistemit të shpërndarjes nëpërmjet dispeçerisë është unik dhe i organizuar në mënyrë hierarkike, në nivel qendror dhe lokal.

Funksionet kryesore të menaxhimit të sistemit të shpërndarjes nëpërmjet dispeçerisë janë:

a) përdorimi i planit operacional të sistemit të shpërndarjes;

b) menaxhimi operativ i sistemit të shpërndarjes në nivel lokal, konform rregullave për ndarjen operative të autoriteteve menaxhuese për instalimet.

Menaxhimi nëpërmjet dispeçerisë është i bazuar në rregullat specifike të organizimit dhe operimit që aplikohen nga dispeçeri qendror i sistemit elektroenergjetik, dispeçeri lokal dhe nga personeli i shërbimit operativ në instalimet dhe objektet e përdoruesve.

Nivelet e menaxhimit të sistemit të shpërndarjes nëpërmjet dispeçerisë janë:

1. Dispeçeria Qendrore e Sistemit Elektroenergjetik.

2. Dispeçeritë lokale të kompanisë(ve) të shpërndarjes.

3. Personeli i shërbimit operativ në instalimet dhe objektet e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes.

[Shënim.Urdhrat e lëshuara nga dispeçeria qendrore e sistemit elektroenergjetik janë detyruesisht të zbatueshme nga të gjitha dispeçeritë lokale, si dhe nga personeli i shërbimit operativ në instalimet dhe objektet e përdoruesve.]

Kompania (të) do të ketë dispeçeritë e veta lokale. Për kontrollimin dhe komandimin e rrjeteve të tensionit të mesëm (MV) do të ketë qendra kontrolli dhe komandimi lokale.

Komandat operative për rrjetin e tensionit të mesëm do të vendosen nga qendrat respektive duke marrë në konsideratë rëndësinë dhe specifikat e instalimeve, nivelin teknik dhe rregullat e sigurimit teknik.

Niveli i menaxhimit nëpërmjet dispeçerisë përfshin:

a) Një departament për komandën operative, me personel që punon me turne, që drejton në kohë reale operimin e instalimeve, duke koordinuar regjimet dhe manovrat.

b) Një departament planifikimi operacional dhe skedulimi operativ, që kryen vëzhgimin dhe analizat e operimit, si dhe përpunimin e rregullave specifike.

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes kanë detyrimin e sigurimit të instalimeve të tyre me pajisje dhe personel të aftë për të kryer menaxhimin e sistemit të shpërndarjes nëpërmjet dispeçerisë.

#### 3.6.2 Kryerja e aktiviteteve nga dispeçeritë e kompanisë(ve) së shpërndarjes

Kompania(të) e shpërndarjes kryen aktivitetet për planin operativ, menaxhimin operativ dhe

aktiviteteve specifike nëpërmjet nivelit të saj te menaxhimit me dispeçeritë lokale respektive.

Kompania(të) e shpërndarjes ka detyrim të kryejë dispeçerimin e sistemit të shpërndarjes në mënyrë jo diskriminuese për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike.

Kompania(të) e shpërndarjes kryen aktivitetet e mëposhtme:

- a) Autorizon personelin për drejtimin operativ konform rregullave në fuqi.
- b) Mbledh, regjistron, arkivon të dhëna statistikore rreth operimit të sistemit të shpërndarjes, sipas rregullave në fuqi.
- c) Siguron shkëmbimin e informacionit me përdoruesit e sistemit të shpërndarjes dhe pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike.
- d) Bashkëpunon me përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për zhvillimin e analizave studimore dhe operative.
- e) Skedulon, zhvillon, rehabiliton dhe modernizon në përputhje me programin vendas të energjisë, me parashikimet konsum/zhvillim, evoluimin teknologjik dhe normat në fuqi, sistemet e veta të dispeçerimit, nën kushtet e pranueshme të efikasitetit ekonomike dhe energjetike.
- f) Koordinon kryerjen, riparimin dhe zhvillimin e një sistemi DSM/SCADA në nivelet e sistemit të shpërndarjes, me qëllim që të lejojë monitorimin dhe menaxhimin e sistemit të shpërndarjes, nëpërmjet dispeçerisë dhe si përfundim:
  - i) zhvillon, modernizon dhe mbron sistemet e veta DSM/SCADA dhe sistemet e telekomunikacionit;
  - ii) u kërkon përdoruesve të sistemit të shpërndarjes të vendosin sistemet lokale SCADA, në përputhje me kërkesat e menaxhimit të sistemit të shpërndarjes nëpërmjet dispeçerisë.
- g) Parandalon çrregullimet e tejzgjatura në sistemin e shpërndarjes dhe siguron zbatimin e normave të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
- h) Jep konsultime në problemet e menaxhimit nëpërmjet dispeçerisë për nivelet e tjera të menaxhimit dhe palët e treta.

### 3.7 Skeduli operacional

Skeduli operacional konsiston në elementet e mëposhtme:

- a) Lista e skemës normale të operimit.
- b) Lista e aktiviteteve të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes për instalimet e sistemit të shpërndarjes.
- c) Lista e mbrojtjes dhe e sistemeve automatike të sistemit të shpërndarjes.
- d) Lista e niveleve të tensionit në sistemin e shpërndarjes.
- e) Regjistrat, proceset dhe arkivat e mjaftueshëm të kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe të dhënat e kërkuara për analizat dhe skedulimin e sistemit të shpërndarjes.
- f) Analizat dhe vërtetimet e programeve të testeve me pajisjet e lidhura me sistemin e shpërndarjes ose që kanë influencë në operimin e tij, ose në operimin e sistemit elektroenergetik. Programet e testeve që ndikojnë në rrjetin 110kV, të cilat duhen aprovuar nga dispeçeria qendrore.

#### 3.7.1 Skedulimi i skemave normale të operimit

Kompania(të) e shpërndarjes paraqet për miratim te Dispeçeria Qendrore e Sistemit Elektroenergetik çdo tremujor skemën normale të operimit për sistemin e shpërndarjes dhe skemën për lidhjen e njësisve të dispeçerueshme të sistemit të shpërndarjes. Propozimet e kompanisë(ve) së shpërndarjes zbatohen vetëm pas miratimit nga dispeçeria qendrore.

Skema normale e operimit për sistemin e shpërndarjes analizohet bazuar në llogaritjen verifikuese, referuar parametrave të mëposhtëm:

- Fluksit të fuqisë nën mbikëqyrjen e kriterit të sigurisë;
- Niveleve të tensionit;
- Nivelet e rrymave të lidhjes së shkurtër;
- Mënyrën e regjimit të neutrit;
- Siguria në operim për automatizimin dhe mbrojtjen e sistemeve;

#### 3.7.2 Skedulimi për operimin dhe mirëmbajtjen e instalimeve të sistemit të shpërndarjes

Kompania(të) e shpërndarjes përgatit dhe i transmeton dispeçerisë qendrore për miratim skedulimin vjetor, tremujor dhe mujor për qarqet që influencojnë në operimin e sistemit elektroenergetik.

### 3.7.3 Menaxhimi operativ i sistemit të shpërndarjes

Menaxhimi operativ i sistemit të shpërndarjes përfshin kryerjen e disa aktiviteteve specifike si më poshtë:

- Mbikëqyr operimin e sistemit të shpërndarjes;
- Drejton operimin e sistemit të shpërndarjes;
- Menaxhon njësitë të cilat nuk janë nën komandimin operativ të Dispeçeria Qendrore e Sistemit Elektroenergjetik;
- Menaxhon sistemet e mbrojtjes dhe automatizimit në sistemin e shpërndarjes.

Kompania(të) e shpërndarjes analizon operimin e sistemit të shpërndarjes nga pikëpamja e përbushjes së programit të operimit dhe e mbikëqyrjes së performancës dhe standardeve për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

### 3.7.4 Skedulimi operativ i punës së sistemit të shpërndarjes

Skedulimi operativ i punës së sistemit të shpërndarjes ka këto komponentë, si më poshtë:

- a) Skedulimi i skemës së operimit;
- b) Skedulimi i njësive që lidhen me sistemin e shpërndarjes.
- c) Skedulimi i nivelit të tensionit;
- d) Skedulimi i sistemit të mbrojtjes dhe automatikës;

Skedulimi operativ i sistemit të shpërndarjes kryhet në përputhje me rregullat e këtij Kodi dhe normat përkatëse që janë aktualisht në fuqi. Aktivitetet specifike të kompanisë(ve) të shpërndarjes koordinohen me aktivitetet e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, duke pasur parasysh rregullat teknike në fuqi dhe kontratat e nënshkruara. KSH-ja ka të drejtë të veprojë menjëherë me kërkesë të dispeçerisë qendrore për mosgadishmërinë e atyre instalimeve (impianteve) elektrike që fusin në rrezik operimin e sigurt të sistemit elektroenergjetik, si dhe furnizimin e konsumatorëve.

KSH-ja nuk mund të modifikojë regjimin apo të axhustojë gjendjen e sistemeve të automatikës dhe të mbrojtjes të vendosura nga Dispeçeria Qendrore e Sistemit Elektroenergjetik pa miratimin paraprak të saj.

### 3.7.5 Komandat e operimit të sistemit të shpërndarjes

KSH-ja implementon programet e operimit që janë në përputhje me skedulimin e operimit në regjimin normal të punës së sistemit të shpërndarjes.

KSH-ja mbikëqyr operimin e sistemit të shpërndarjes përmes mbledhjes dhe marrjes në dorëzim të të dhënave të nevojshme, referuar:

- a) Parametrave tipike të regjimit të operimit:
  - frekuencës;
  - tensionit në nyjet e sistemit të shpërndarjes;
  - fluksit të fuqisë aktive dhe reaktive të elementeve të sistemit të shpërndarjes;
  - fuqisë aktive dhe reaktive të injektuar në secilën pikë lidhëse të sistemit të shpërndarjes.
- b) Konfigurimit të sistemit të shpërndarjes.
- c) Tejkallimit të disa prej kufijëve të përcaktuar të parametrave të operimit.
- d) Ngjarjeve të ndodhura në sistemin e shpërndarjes ose edhe të atyre që priten të ndodhin.

KSH-ja mbikëqyr sistemin e shpërndarjes përmes sistemit të saj të informacionit dhe të telekomunikacionit, tipik për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe transmetimin në të njëjtën kohë dhe për komandat e nevojshme për menaxhimin e sistemit të shpërndarjes.

Dispeçeria Qendrore e Sistemit Elektroenergjetik ka autoritetin të japë urdhra konform Kodit të Sistemit të Transmetimit dhe rregullave në fuqi për kompaninë (të) e shpërndarjes, ndërkohë që KSH-ja u jep urdhra përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, referuar regjimit të punës së pajisjeve dhe instalimeve të sistemit të shpërndarjes.

Urdhrat e Dispeçerisë Qendrore të Sistemit Elektroenergjetik duhet të përbushen pa vonesë, përveç rasteve kur është në rrezik siguria e personelit dhe integriteti i pajisjeve.

KSH-ja jep urdhra për koordinimin dhe manovrimin në sistemin e shpërndarjes sipas rregullave në fuqi. Personeli i shërbimit operativ do të ekzekutojë manovrat sipas normave teknike specifike dhe rregullave të sigurisë në punë.

KSH-ja është e detyruar dhe e autorizuar të marrë të gjithë masat e nevojshme për kufizimin

e përhapjes së avarive dhe për të ruajtur operimin normal në rast të një gjendjeje të paqendrueshme operimi si pasojë e urdhrave të dhëna nga Dispeçeria Qendrore e Sistemit Elektroenergjetik.

Në rrethana të operimit në gjendje avarie, KSH-ja ka të drejtën të kufizojë konsumin duke bërë shkyçjen manuale, konform normave në fuqi ose urdhrave të Dispeçerisë Qendrore, me qëllim që të ruajë në gjendje normale operimi sistemin elektroenergjetik.

### 3.8 Raportimi i Ngjarjes

Kodi i Shpërndarjes vendos kërkesat për raportimin me shkrim të ngjarjeve në sistemin e shpërndarjes. Informacioni mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes do të shkëmbehet sipas kërkesës së arsyeshme të të dy palëve.

Objektivi i këtij paragrafi është vendosja e dispozitave për informacion më të detajuar me shkrim mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes, përfshirë dhe hetimin e përbashkët të incidenteve dhe të ngjarjeve të raportuara gojarisht. Kërkesat për raportim aplikohen për të gjithë përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes. KSH-ja dhe përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes do të emërojnë përfaqësues dhe do të vendosin kanale komunikimi për të siguruar komunikimin ndërmjet tyre.

Komunikimet, për aq sa është e mundur, do të jenë direkte në mes përdoruesve të sistemit të shpërndarjes të përfshirë në ngjarje dhe kompanisë(ve) së shpërndarjes. Megjithatë, kjo nuk pengon komunikimin me përfaqësuesit e caktuar nga përdoruesi.

Kompanisë(ve) së shpërndarjes ose përdoruesve të sistemit të shpërndarjes do t'u dërgohet një raport me shkrim ose në formë elektronike, sipas rastit. Raporti do të përmbajë njoftimin me më shumë detaje lidhur me incidentin ose defektin, duke përfshirë edhe informacionin që është bërë i njohur për incidentin ose defektin pas njoftimit.

#### 3.8.1 Hetimi i përbashkët

Aty ku është deklaruar një incident ose defekt dhe është paraqitur një raport, kompania(të) e shpërndarjes ose përdoruesit e sistemit të shpërndarjes mund të kërkojnë me shkrim që të kryhet një hetim i përbashkët. Një grupi hetimi do të jetë i nevojshëm për incidentin ose defektin që do hetohet dhe do vendoset nga të gjitha palët e përfshira.

Një hetim i përbashkët do të zhvillohet nga të gjitha palët e prekura që bien dakord. Forma, rregullat, procedurat dhe të gjitha çështjet lidhur me hetimin e përbashkët do të vendosen në marrëveshjen e hetimit të përbashkët. Në mungesë të marrëveshjes, hetimi i përbashkët nuk do të zhvillohet, por do të zhvillohet hetimi nga organet e ngarkuara nga ligji. Çështjet në raportin e shkruar për incidentin e rëndësishëm duhet të përfshijnë për kompaninë(të) e shpërndarjes:

- Datën dhe orën e incidentit të rëndësishëm;
- Vendin;
- Pajisjet e përfshira;
- Përshkrimin e shkurtër të incidentit;
- Detaje të çdo kontrolli të ndërmarrë;
- Konkluzione dhe rekomandime nëse aplikohen;
- Kohëzgjatja e incidentit;
- Data e parashikuar dhe koha e rikthimit në shërbim normal.

Çështjet në raportin e shkruar për incidentin e rëndësishëm duhet të përfshijnë për gjeneruesin e lidhur në sistemin e shpërndarjes:

- Gjenerimin e ndërprerë;
- Performancën MVAR;
- Datën e parashikuar dhe rikthimin në shërbim normal.

#### 3.8.2 Testet e sistemit të shpërndarjes

Kodi i Shpërndarjes cakton përgjegjësitë dhe procedurat për rregullimin dhe kryerjen e testeve të sistemit të shpërndarjes. Testet e sistemit të shpërndarjes janë ato teste që përfshijnë aplikimin e simuluar ose të kontrolluar të kushteve të pazakonta ose ekstreme në sistemin e shpërndarjes, por nuk përfshijnë testet e komisionimit ose rikomisionimit, ose çdo test tjetër të një natyre më të vogël.

Objektivat e kërkesave të kodit të shpërndarjes janë:

- Të sigurojnë që procedurat për rregullimin dhe kryerjen e testeve të Sistemit nuk

kërcënojnë sigurinë e personelit ose publikut të gjerë dhe përbëjnë kërcënim minimal për sigurinë e furnizimit, integritetin e centraleve ose pajisjeve elektroenergjetike dhe nuk janë në disavantazh për kompaninë(të) e shpërndarjes dhe përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

- Të vendosë procedurat që do ndiqen për të caktuar dhe raportuar testet e sistemit të shpërndarjes.

Kërkesat aplikohen për të gjithë përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes.

Nëse testi i sistemit propozohet nga kompania(të) e shpërndarjes ose përdoruesi i lidhur me sistemin e shpërndarjes dhe ai ndikon ose mund të ndikojë mbi sistemin e transmetimit, atëherë do të aplikohen dispozitat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

Kur kompania(të) e shpërndarjes ose përdoruesi i sistemit të shpërndarjes synon të ndër marrë një test të sistemit që mund të ketë efekt të rëndësishëm në sistemet e tjera, zakonisht duhet t'i jepet njoftim gjashtë muaj më parë nga personi që i propozon testin kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe atyre përdoruesve të sistemit të shpërndarjes që mund të ndikohen nga një test i tillë i sistemit të shpërndarjes.

Propozimi do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë detajet mbi natyrën dhe qëllimin e testit të propozuar dhe do të tregojë nivelin dhe situatën e instalimit ose të pajisjes së përfshirë. Nëse informacioni i dhënë në njoftimin e propozimit konsiderohet i pamjaftueshëm nga marrësi, ai do të kontaktojë personin që propozon testin me një kërkesë me shkrim për informacion të mëtejshëm që do të sigurohet sa më shpejt të jetë e mundur.

Nëse kompania(të) e shpërndarjes dëshiron të ndërmarrë një test të sistemit të përdoruesit, kompania(të) e shpërndarjes do të paraqesë një kërkesë për atë test të përdoruesit respektiv. KSH-ja do të koordinojë testin e sistemit të shpërndarjes ose të përdoruesit, duke përdorur informacionin që i është dhënë dhe do të identifikojë se cilët përdorues mund të ndikohen nga testi i propozuar i sistemit. Pas marrjes së propozimit për testin, kompania(të) e shpërndarjes do të vlerësojë ndikimin e testit dhe do të diskutojë propozimet me përdoruesit e sistemit të shpërndarjes të identifikuar si të mundshëm për t'u prekur.

Brenda një muaji nga marrja e propozimit për testin e sistemit, KSH-ja do t'i paraqesë një raport personit që propozon testin, që do të përmbajë:

- propozimin për kryerjen e testit;
- mënyrën me të cilën do të monitorohet;
- ndarjen e kostove mes palëve të prekura;
- parimin e përgjithshëm sipas të cilit personi që propozon testin do të përballojë kostot;
- çështje të tjera që kompania(të) e shpërndarjes i konsideron të përshtatshme; të përmbledhë procedurën që do të ndiqet dhe programin e propozuar për testin dhe kështilla për kostot.

Raporti i propozimit do t'u paraqitet gjithë atyre që kanë marrë njoftim. Nëse raporti i propozimit të rënë dakord mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe personit që propozon testin miratohet nga gjithë marrësit, testi mund të vazhdojë.

Të paktën një muaj para datës së testit të propozuar të sistemit, kompania(të) e shpërndarjes do t'u paraqesë të gjithë marrësve të njoftimit për propozim një program të quajtur programi i testit përfundimtar, që tregon afatet e propozuara, një listë të stafit të përfshirë në kryerjen e testit dhe që përgjigjet për sigurinë e vendit, si dhe çështje të tjera që kompania(të) e shpërndarjes i konsideron të nevojshme. Programi përfundimtar i testit do të detyrojë gjithë pjesëmarrësit që të veprojnë në përputhje me masat që përmbahen në program lidhur me testin e propozuar të sistemit.

Në përfundim të testit të sistemit, personi që propozon testin do të përgjigjet për përgatitjen e një raporti me shkrim për testin që do t'ia paraqesë kompanisë(ve) së shpërndarjes.

Raporti përfundimtar do të përfshijë një përshkrim të centralit dhe/ose instalimit të testuar, së bashku me rezultatet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse. Rezultatet e testeve do t'u raportohen palëve përkatëse duke marrë parasysh çështjet e konfidencialitetit. Të gjitha procedurat e testit të sistemit do të respektojnë legjislacionin në fuqi.

### 3.8.3 Monitorimi i sistemit të shpërndarjes dhe shqyrtimi i instalimeve të përdoruesve

Me qëllim që të ushtrojë përgjegjësitë e veta lidhur me sigurinë dhe operimin ekonomik të sistemit të shpërndarjes dhe në përputhje me kushtet e licencës, kompania(të) e shpërndarjes do të organizojë dhe kryejë monitorimin dhe testimin e centraleve ose instalimeve elektrike të

përdorueseve të sistemit të shpërndarjes.

Objektivi i këtij seksioni është specifikimi i kërkesave të kompanisë(ve) së shpërndarjes për të testuar dhe/ose monitoruar sistemin e shpërndarjes për të siguruar që përdoruesit nuk operojnë jashtë parametrave teknikë të kërkuar nga Kodi i Shpërndarjes. Kërkesat aplikohen për të gjithë përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes. Periodikisht kompania(të) e shpërndarjes do të përcaktojë nevojën për të testuar dhe monitoruar cilësinë e furnizimit në pika të ndryshme të sistemit të shpërndarjes. Kërkesat për testim specifik dhe/ose monitorim mund të nisen nga marrja e ankesave specifike për cilësinë e furnizimit në sistemin e shpërndarjes. Kur kërkohet testimi ose monitorimi në pikën e lidhjes me një përdorues të sistemit të shpërndarjes, kompania(të) e shpërndarjes do të njoftojë përdoruesin e përfshirë dhe do të bëjnë të disponueshme rezultatet e këtyre testeve për përdoruesin, si dhe rekomandimet përkatëse.

Nëse zbulohet se një përdorues operon jashtë kufijve teknikë të specifikuar në Kodin e Shpërndarjes, atëherë përdoruesi do ta rregullojë situatën ose do ta shkëpusë pajisjen që shkakton probleme nga instalimet e tij elektrike të lidhura me sistemin e shpërndarjes menjëherë ose brenda kohës siç është rënë dakord me kompaninë(të) e shpërndarjes.

Paaftësia e vazhdueshme për të korrigjuar situatën do të rezultojë me shkëputjen e përdoruesit sipas marrëveshjes së lidhjes. Herë pas here KSH-ja do të monitorojë efektet e përdoruesve të saj mbi sistemin e shpërndarjes. Monitorimi normalisht do të lidhet me:

- Sasinë e energjisë elektrike aktive.
- Energjinë elektrike reaktive ose luhatjet.
- Harmonikat e transferuara përgjatë pikës së lidhjes.
- Kur përdoruesi eksporton ose importon energji elektrike aktive ose reaktive më tepër nga sa është përcaktuar në marrëveshjen e lidhjes ose shkakton shqetësime, kompania(të) e shpërndarjes do të njoftojë përdoruesin dhe përdoruesi do të kufizojë transferimin e energjisë elektrike brenda parametrave të specifikuar.

- Herë pas here kompania(të) e shpërndarjes mund të kontrollojë që përdoruesit e lidhur me sistemin e shpërndarjes të plotësojnë kërkesat e vendosura për mbrojtjen dhe pajisjet e mbrojtjes.

### 3.9 Koordinimi i sigurisë

Kodi i shpërndarjes specifikon kriteret e menaxhimit të sistemit të shpërndarjes nga pikëpamja e sigurisë që do të aplikohen nga kompania(të) e shpërndarjes për të plotësuar kërkesat ligjore, kushtet dhe detyrimet e licencës së shpërndarjes.

Kritere dhe standarde të ngjashme të menaxhimit të sigurt të sistemit do të sigurohen nga përdorues të tjerë të sistemit të shpërndarjes, kur kryejnë punë ose teste për shkëmbimet operative me kompaninë(të) e shpërndarjes. Koordinimi i sigurisë specifikon kriteret e menaxhimit të sigurt që do aplikohen për sigurinë e personave që punojnë në sistemin e shpërndarjes ose në kufijtë operativë dhe pronësorë të tij me përdoruesit. Koordinimi i sigurisë specifikon kriteret e menaxhimit të sigurt që aplikohen për kompaninë(të) e shpërndarjes dhe përdoruesit kryesorë të sistemit të shpërndarjes.

Parimet e menaxhimit të sigurt (sistem i menaxhimit të sigurt) dhe procedurat për të siguruar shëndetin dhe sigurinë e gjithë personelit do të specifikohen nga kompania(të) e shpërndarjes dhe përdoruesit respektivë që lidhen me to, konform legjislacionit në fuqi.

Në mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesve do të ketë marrëveshje të përbashkëta për të përcaktuar se cili sistem i menaxhimit të sigurisë do të përdoret për vendet ose vendndodhjet ku ekziston një kufi operativ dhe do të mbahet dokumentacioni i duhur për masat e sigurisë. Personeli që bën kontrollin, operimin, punën ose testimin e vendeve ose pajisjeve të përdoruesve që janë të lidhura me sistemin e shpërndarjes, do të ketë autorizim me shkrim nga KSH-ja. Në mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesve do të bëhen marrëveshje të përbashkëta që specifikojnë përgjegjësitë për pajisjet e sistemit ose kontrollit dhe që do të sigurojnë që vetëm njëra palë është përgjegjëse në çdo moment, për çdo çështje lidhur me vendin ose pajisjen.

Në çdo moment, kompania(të) e shpërndarjes dhe përdoruesit kryesorë do të caktojnë një person ose disa persona përgjegjës për koordinimin e sigurisë në sistemet respektive. Kompania(të) e shpërndarjes dhe çdo përdorues kryesor do të mbajnë një sistem të përshtatshëm dokumentacioni që regjistron të gjitha ngjarjet e rëndësishme operuese që kanë ndodhur në sistemin e shpërndarjes ose sistemet e tjera të lidhura me të dhe koordinimin e masave të rëndësishme të sigurisë në punë.

Kompania(të) e shpërndarjes dhe përdoruesit do të shkëmbejnë skemat elektrike që japin informacion të mjaftueshëm për kryerjen e detyrave nga personeli i kontrollit.

Procedura e mëposhtme vendos kërkesat bazë të sigurisë për shkëmbimet ndërmjet përdoruesve dhe KSH-së. Këto procedura janë të nevojshme për sigurinë e gjithë atyre që mund të punojnë në të dyja anët e kufirit ose në kufirin ndarës. Për punën e sigurt dhe procedurat e komunikimit do të jenë të disponueshme rregulla të shkruara që do të përdoren nga të gjithë personat që mund të duhet të punojnë ose të përdorin facilitetet në kufij.

Pajisjet elektrike të lidhura në të dyja anët e kufijve ndarës dhe pajisjet ndarëse do të jenë nën kontrollin e një personi të caktuar në çdo anë. Për të lejuar kryerjen e punës në mënyrë të sigurt në të dyja anët e kufirit, do të sigurohen mjete të përshtatshme izolimi sipas rregullave në fuqi. Aty ku është e nevojshme të parandalohet rreziku, do të sigurohen facilitete të përshtatshme për tokëzimin në të dyja anët e kufirit ndarës për të lejuar kryerjen e punës në mënyrë të sigurt në shkëmbim ose në secilën anë të tij.

Për të gjitha pajisjet elektrike që ndodhen afër njëra-tjetrës, puna e të cilave bëhet në rrethana që mund të shkaktojnë rrezik, do të sigurohen hapësira të përshtatshme pune, mjete të përshtatshme aksesit, dhe aty ku është e nevojshme një ndriçim i përshtatshëm. Të gjithë pajisjet elektrike do të identifikohen në mënyrë të përshtatshme, kur është e nevojshme për të parandaluar rrezikun.

Instalimet elektrike dhe pajisjet do të plotësojnë kërkesat ligjore në fuqi. Operimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të përdoruesve do të kryhet vetëm nga personat e autorizuar. Para komisionimit të centralit, kompania(të) e shpërndarjes do të vendosë procedurat e operimit. Informacioni për operimin dhe/ose tokëzimin e pajisjeve elektrike të përdoruesve do të paraqitet qartë në kabinën e kyçjes së tensionit të mesëm dhe të ulët të përdoruesve. Rregullat e sigurisë detajojnë procedurat e sigurisë dhe kërkesat e sigurimit teknik që do të respektohen nga gjithë personeli që punon në sistemin e shpërndarjes.

3.10 Siguria e furnizimit dhe standardet e performancës për shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike

#### 3.10.1 Fusha e aplikimit

Për zbatimin e standardeve të performancës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike janë vendosur treguesit dhe nivelet e performancës lidhur me:

e) Lidhjen e përdoruesve në sistemin e shpërndarjes.

f) Sigurimin si të vazhdimësisë së furnizimit, ashtu dhe të cilësisë së energjisë elektrike të shpërndarë.

g) Ndërprerjet e programuara, si pasojë e punimeve të programuara të mirëmbajtjes dhe riparimit.

h) Ndërprerjet e paprogramuara si pasojë e avarive dhe defekteve të ndryshme.

i) Zgjidhjen e ankesave të përdoruesve në lidhje me cilësinë e energjisë elektrike.

j) Zgjidhjen e ankesave të përdoruesve.

Këto standarde do të aplikohen për marrëdhëniet ndërmjet KSH-së dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes kur ato:

a) kanë instalime në tensionin nominal alternativ, në kufijtë  $0.4 \text{ kV} \geq 110 \text{ kV}$  dhe frekuencë 50 Hz;

b) nuk shkaktojnë çrregullime në furnizimin e përdoruesve të tjerë të sistemit të shpërndarjes nëpërmjet regjimit të tyre të punës;

c) janë brenda fuqisë maksimale, të vendosura në miratimin teknik për lidhje dhe vëzhgim të kushteve të vendosura në kontratë.

Këto standarde nuk do të aplikohen në rastet e:

a) forcave madhore;

b) operimit (punës) jonormal të sistemit të shpërndarjes, të përcaktuar nga kompania(të) e shpërndarjes;

c) ndodhive aksidentale të shkaktuara nga palët e treta.

#### 3.10.2 Atributet dhe kompetencat

Për vëzhgimin e standardeve të performancës, KSH-ja duhet të sigurojë:

a) aftësi për zgjidhje të ankesave dhe peticioneve të përdoruesve të sistemit të shpërndarjes sipas këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi;

b) evidencën e aplikimeve për lidhje në rrjet dhe njoftimet e lëshuara për pranimin teknik të lidhjes;

c) evidencën e rezultateve të aktivitetit që ka të bëjë me cilësinë e energjisë elektrike të shpërndarë tek përdoruesit e sistemit të shpërndarjes;

d) planifikim të punimeve të programuara për mirëmbajtje dhe riparime;

e) vazhdimësi të shërbimeve të shpërndarjes, të kryer për përdoruesit.

### 3.10.3 Treguesi i performancës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike

Përgjegjësia e kompanisë(ve) së shpërndarjes, në lidhje me furnizimin e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes me energji elektrike, përfundon në pikën kufitare të instalimeve ndërmjet palëve, siç specifikohet në kontratën për shërbimin e shpërndarjes. Vendi dhe numri i pikave kufitare do të propozohet nga kompania(të) e shpërndarjes dhe do vendoset me marrëveshje të ndërsjellë me përdoruesin e sistemit të shpërndarjes.

### 3.10.4 Ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike

Ndërprerjet aksidentale (të rastit)

Kompania(të) e shpërndarjes do të rivendosë furnizimin, sa më shpejt që të jetë e mundur, për konsumatorët e sistemit të shpërndarjes, të dëmtuar nga ndodhitë aksidentale, (të rastit) të cilat kanë pasur si rezultat ndërprerjen e furnizimit. Kompania(të) e shpërndarjes do të regjistrojë të gjitha ankesat (reklamimet), ndërsa ankuesi (reklamuesi) duhet të informohet rreth numrit të regjistrimit. Çdo ankesë (reklamim) duhet t'i referohet këtij numri të regjistruar.

Kompania(të) e shpërndarjes duhet t'i tregojë ankuesit (reklamuesit) kohëzgjatjen e përafërt deri në rifillimin e furnizimit. Kompania(të) e shpërndarjes duhet të sigurojë mbërritjen e ekipit të ndërhyrjes, në minimumin e mundshëm të kohës, që nga momenti i njoftimit të ndërprerjes, dhe ta eliminojnë atë sa më shpejt të jetë e mundur praktikisht.

### 3.10.5 Siguria e furnizimit

Kompania(të) e shpërndarjes do të ndërmarrë veprime të arsyeshme për të ruajtur sigurinë e furnizimit nga sistemi i shpërndarjes për përdoruesit e vet. Furnizimi nuk mund të jetë i siguar, përderisa kemi defekte, ndërprerje të planifikuara për mirëmbajtje dhe ndërprerje për realizimin e punëve të reja, si dhe rrethana të tjera që janë jashtë kontrollit të KSH-së dhe mund të shkaktojnë ndërprerje. Në raste të tilla KSH-ja do të ndërmarrë veprimet e duhura për të rinisur furnizimin sa më shpejt të jetë e mundur. Llojet e ndërprerjeve janë:

a) Ndërprerjet si rezultat i defekteve: KSH-ja do të ndërmarrë veprimet e duhura për të rifilluar furnizimin me energji elektrike të klientëve të vet sipas paragrafëve të këtij Kodi. Në rrethana të veçanta, kohëzgjatja e ndërprerjeve mund të jetë e madhe dhe në këto rrethana KSH-ja do të veprojë për të informuar klientët për progresin e bërë.

b) Ndërprerjet e planifikuara: Kompania(të) e shpërndarjes do të njoftojë ndërprerje të nevojshme për mirëmbajtjet dhe riparimet e programuara.

Kompania(të) e shpërndarjes do të bëjë njoftimin me mjetet e informimit publik, që varet nga madhësia e zonës së prekur (dëmtuar), të paktën 24 orë para, duke treguar gjithashtu edhe kohëzgjatjen e ndërprerjes.

Ndërprerjet e programuara, të cilat nuk janë njoftuar më parë, mund të ankohen (reklamohen) nga përdoruesi (konsumatori) i sistemit të shpërndarjes, ndërsa kompania(të) e shpërndarjes do të riparojë dëmtimet përkatëse në përputhje me kontratën e shpërndarjes.

c) Shkurtimet e furnizimit: Në disa rrethana mund të jetë e nevojshme t'u kërkohet konsumatorëve të reduktojnë ngarkesën e tyre ose të përdorin burimet rezervë të furnizimit atje ku është e nevojshme. Në këto situata KSH do të bëjë një përpjekje për të mbajtur aksesin në sistemin e saj dhe do të lajmërojë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, për shkurtimet e furnizimit 24 orë përpara, për zonat e prekura.

d) Kufizimet: Në situata kur ka ulje të gjenerimit mund të kërkohen kufizime. Në këto rrethana KSH do të njoftojë konsumatorët nëse është e mundur.

KSH mund t'i zgjidhë(stakojë) përdoruesit nga sistemi i shpërndarjes në disa rrethana. Këto

rrethana mund të përfshijnë:

- Kur instalimet e përdoruesëve ose përdorimi i energjisë elektrike pengon operimin e pranueshëm të sistemit të shpërndarjes, të transmetimit ose krijon shqetësime për përdoruesit e tjerë të sistemit të shpërndarjes.

- Kur KSH vëren që instalimet e përdoruesit janë në kushte të rrezikshme.

- Kur riparim, zëvendëson ose mirëmban sistemin e shpërndarjes dhe kërkohet stakimi i pikës së lidhjes me përdoruesin.

- Kur një përdorues i sistemit të shpërndarjes e rrit konsumin për ta përdorur për një palë tjetër.

- Në çdo rrethanë tjetër në të cilën stakimi është i nevojshëm ose i duhur për t'i bërë të mundur KSH të përputhet me Kodin e Shpërndarjes dhe/ose të operojë sistemin e shpërndarjes në përputhje me rregullat, direktivat, normat, rregulloret dhe ligjet në fuqi.

#### 3.10.6 Treguesit e rezultateve vjetore

Treguesit e rezultateve vjetore të performancës së sistemit të shpërndarjes konsistojnë në:

a) Numrin e ndërprerjeve të programuara sipas niveleve të tensioneve;

b) Kohëzgjatjen e ndërprerjeve të programuara sipas niveleve të tensionit;

c) Numrin e përdoruesve të prekur nga ndërprerje të tilla në afate kohore sipas niveleve të tensionit dhe sipas kategorisë të konsumatorëve;

d) Numrin e incidenteve dhe të avarive;

e) Kohëzgjatjen e ndërprerjeve nga incidentet dhe avaritë sipas niveleve të tensionit.

Kur ankimi (reklamimi) me shkrim është bërë lidhur me nivelin e tensionit, kompania(të) e shpërndarjes do të verifikojë këtë parametër në pikën kufitare me përdoruesin e sistemit të shpërndarjes dhe do ta analizojë dhe do ta informojë përdoruesin rreth rezultateve të analizave dhe veprimeve të marra për rregullim. Afati standard për përgjigje ndaj ankimeve (reklamimeve) është 15 ditë kalendarike.

Çdo ankimi do t'i jepet një numër regjistrimi, ndërsa ankimesi do të njoftohet për këtë numër. Çdo ankim (reklamim) i mëvonshëm do t'i referohet këtij numri të regjistruar.

#### 3.10.7 Treguesit e rezultateve vjetore për nivelet e tensionit:

Treguesit e rezultateve vjetore të performancës së tensionit në sistemin e shpërndarjes konsistojnë në:

a) Numrin e ankimeve (reklamimeve) për nivelet e tensionit.

b) Numrin e ankimeve, për të cilët është dhënë përgjigje.

c) Numrin e ankimeve të cilëve nuk u është dhënë zgjidhje.

#### 3.10.8 Treguesit vjetorë lidhur me ankimet e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes

Treguesit vjetorë në lidhje me ankimet konsistojnë në:

a) Numrin e ankimeve me shkrim.

b) Numrin e ankimeve të specifikuara, të cilave u është dhënë një përgjigje.

c) Numrin e ankimeve të specifikuara, të cilave nuk u është dhënë një përgjigje.

Çdo kompani(të) e shpërndarjes do t'u përgjigjet (ose duke e zgjidhur ankimin ose duke i dhënë përgjigje me shkrim) të gjitha ankimeve (reklamimeve) të adresuara me shkrim nga përdoruesit e sistemit të shpërndarjes. Afati maksimal për t'iu përgjigjur ankimeve, përveç atij të specifikuar në këtë dokument, është 30 ditë kalendarike.

Çdo ankim do të ketë një numër të regjistruar, që do t'i komunikohet reklamuesit. Çdo reklamim i mëvonshëm do t'i referohet numrit të regjistruar.

#### 3.10.9 Ndjekja dhe regjistrimi i treguesve të performancës

Për regjistrimin e ankimeve, të bëra nga përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, çdo kompani (të) e shpërndarjes do të organizojë:

a) Një qendër për marrëdhëniet me klientët, për çdo seksion të njësive territoriale (agjenci) për regjistrimin e ankimeve;

b) Një shërbim telefonik;

c) Një sektor të specializuar për analizën e ankimeve.

Për treguesit e tjerë të performancës, kompania(të) e shpërndarjes do të garantojë ndjekjen e tyre nëpërmjet sektorëve të specializuar.



## KAPITULLI IV LIDHJET

Kapitulli i lidhjeve specifikon kushtet, kriteret dhe afatet kohore që duhet të plotësojnë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për t'u lidhur ose për të modifikuar lidhjet e tyre ekzistuese në sistemin e shpërndarjes.

### 4. Qëllimi

Qëllimi i këtij paragrafi është që të përmbushë objektivat e mëposhtëm:

1. Gjithë përdoruesit ekzistues të sistemit të shpërndarjes ose ata të perspektivës trajtohen në mënyrë të barabartë.

2. Çdo lidhje e re nuk duhet të shkaktojë ndonjë efekt negativ te përdoruesit ekzistues, ose një lidhje e re nuk duhet të ndikohet nga efektet negative të përdoruesve ekzistues.

3. Të ndihmojë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes që të zbatojnë detyrimet e tyre dhe të sigurojnë operim dhe mirëmbajtje me cilësi të lartë të instalimeve të tyre.

4. Të specifikojë qartë dhe në një format standard, detyrimet dhe përgjegjësitë për të gjithë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, për çdo vend ku bëhet/modifikohet një lidhje.

#### 4.1 Procedura e aplikimit për lidhje

Çdo përdorues i sistemit të shpërndarjes që kërkon të realizojë lidhje të reja ose të modifikojë lidhjet ekzistuese të lidhjes në sistemin e shpërndarjes dhe/ose përdorimin e tij, duhet të ndjekë procedurat e vendosura në këtë kapitull.

KSH do të ndjekë procedurat dhe afatet e kohës të specifikuara në këtë Kod në procesin e aplikimit, modifikimit, pranimit ose mospranimit të një kërkesë.

#### 4.1.2 Aplikimi për lidhje

Çdo përdorues i sistemit të shpërndarjes që kërkon të përdorë sistemin e shpërndarjes mund të paraqesë një aplikim për lidhje në KSH, në formatin e hartuar nga KSH.

Kërkesa e aplikimit duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

a) emrin, adresën, numrin e telefonit/fax-it/E-mail e aplikantit;

b) qëllimin e aplikantit për lidhjen (njësia e gjenerimit, instalime të shpërndarjes, instalime të ngarkesës etj.);

c) angazhimin me shkrim të aplikantit për të zbatuar Kodin e Shpërndarjes;

d) dokumentacionin që i bashkëngjitet aplikimit sipas specifikimeve të paragrafëve të mëposhtëm.

4.2 Informacioni specifik i kërkuar për t'u lidhur me rrjetin e shpërndarjes në tension të ulët

Për lidhje në tension të ulët KSH kërkon informacionin e mëposhtëm:

- Emrin e objektit (vendi i konsumit);

- Vendosjen (përcaktimi/vendndodhja) e objektit, adresën. Bashkëngjijtjen e një harte të vendndodhjes në zonën respektive, nëse kërkohet nga KSH;

- Specifikën e aktivitetit (prodhimin, tregtimin, shërbimet etj.);

- Llojin e lidhjes së kërkuar (njëfazore ose trefazore);

- Fuqinë e instaluar në KW;

- Projektin elektrik të instalimeve të përdoruesit të bërë nga inxhinier elektrik i licencuar;

- Deklaratën mbi konformitetin e instalimeve të brendshme të përdoruesit;

- Kërkesat për KW ose kVA maksimale;

- Kërkesën vjetore për energji elektrike në KW-orë;

- Tipin dhe ngarkesën elektrike të pajisjes që do të lidhet (si numri dhe fuqia e motorëve, ndriçimi etj.);

- Faktorin mesatar të fuqisë, me të cilin do të punojë konsumatori ( $\cos\phi$ );

- Datën kur kërkohet lidhja;

Nëse vlerësimi paraprak i këtyre të dhënave tregon se kërkohet me shumë informacion i detajuar, atëherë ai do t'i sigurohet nga përdoruesi/konsumatori respektiv kompanisë(ve) së shpërndarjes sipas kërkesës.

4.2.1 Informacioni specifik i kërkuar për t'u lidhur me rrjetin e shpërndarjes në tension të mesëm dhe të lartë

Për lidhje në tension të mesëm dhe të lartë do të kërkohej informacioni i mëposhtëm:

- Emri i objektit (vendi i konsumit);
- Vendosja (përcaktimi/vendndodhja) e objektit, adresa. Bashkëngjitur një skemë me vendndodhjen në zonën respektive;

Specifika e aktivitetit (prodhimi, shërbimi, si dhe mënyra e punës, numri i turneve, ditët e punës në javë etj.);

- Fuqia e instaluar në MW;
- Grafiku i ngarkesës;
- Faktori mesatar i fuqisë me të cilin do të punojë konsumatori ( $\cos\phi$ );
- Projekti elektrik i instalimeve të përdoruesit të bërë nga inxhinier elektrik i licencuar;
- Deklarata mbi konformitetin e instalimeve të brendshme të përdoruesit;
- Në qoftë se përdoruesi është i lidhur dhe kërkon modifikim të lidhjes ekzistuese, duhet të paraqesë dhe: Mënyrën me të cilën furnizohet objekti aktualisht (skema, karakteristikat, rrugët e furnizimit dhe mënyra e matjes së energjisë elektrike të konsumuar). Duhet dhënë gjithashtu një kopje e marrëveshjes së lidhjes të marrë më parë dhe skema e vendosjes së instalimeve të furnizimit me pikat ekzistuese marrëse dhe matëse;

- Kërkesën për energji elektrike aktive maksimale dhe minimale vjetore dhe 5 vjeçare;
- Kërkesën për energji elektrike reaktive maksimale dhe minimale vjetore dhe 5 vjeçare;
- Tipi i ngarkesës dhe marrëveshjet e kontrollit (p.sh. mënyra e lëshimit të motorit etj.);
- Ngarkesa maksimale në çdo fazë;
- Harmonikat maksimale të rrymës që mund të imponohen mbi sistemin e shpërndarjes;
- Detajet e variacioneve të ngarkesës ciklike ose ngarkesave luhatëse (si më poshtë);
- Ngarkesat shqetësuese (çrregulluese);
- Prospektet e përgjithshme të pajisjeve të reja të instaluara përfshirë detajet e ngarkesave shqetësuese. Këto janë ngarkesa që kanë potencialin të fusin harmonika, luhatje (flickers) ose mungesë balance në sistemin e shpërndarjes;

- Ngarkesat luhatëse;

- Të dhëna teknike për pajisjet që gjenerojnë/observojnë fuqi reaktive, nëse ka;

- Përgjegjësitë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;

- Data kur kërkohej lidhja.

Përdoruesit kryesorë që aplikojnë për lidhje duhet të garantojnë edhe:

- Përgjegjësitë për kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve;

- Përgjegjësitë për operimin e pajisjeve;

- Përgjegjësitë për sigurinë e personelit dhe sigurimit teknik.

Në disa raste, mund të kërkohej më shumë informacion i detajuar për të lejuar një vlerësim të plotë të efektit të ngarkesës së përdoruesit të sistemit të shpërndarjes në sistemin e shpërndarjes. Ky informacion mund të përfshijë një program të propozuar për futjen në punë të objektit. Ky informacion do të kërkohej në mënyrë specifike nga kompania(të) e shpërndarjes, kur është e nevojshme, dhe do të sigurohet nga përdoruesi brenda një periudhe kohore të arsyeshme.

Përdoruesi i sistemit të shpërndarjes do të informojë kompaninë(të) e shpërndarjes më përpara, nëse propozohet për të bërë ndonjë ndryshim të rëndësishëm në lidhje, linjat elektrike ose pajisjet elektrike, të instalojë ose të operojë ndonjë pajisje gjenerimi ose të bëjë ndonjë gjë tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin e shpërndarjes ose të kërkojë ndryshime në lidhje. Përdoruesit do t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes çdo informacion të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga kompania(të) e shpërndarjes mbi natyrën dhe përdorimin e pajisjeve elektrike në ambientet e përdoruesit.

Pas marrjes së të gjitha të dhënave dhe informacionit të paraqitur më sipër kompania(të) e shpërndarjes do të realizojë studimin përkatës për lidhjet e reja ose modifikimin e lidhjeve ekzistuese në tension të mesëm dhe në tension të lartë. Për përcaktimin e vendit për lidhje të re, kompania(të) e shpërndarjes do të bazohet duke analizuar këta faktorë:

- i) Nivelin e sigurisë së furnizimit;
- ii) Qëndrueshmërisë statike dhe dinamike të elementeve të sistemit të shpërndarjes;
- iii) Nivelin e rrymës së lidhjes së shkurtër;
- iv) Efektin e humbjeve teknike për rastin e lidhjes së vjetër dhe të re në rrjetin e shpërndarjes;
- v) Vlerësimin e mënyrës së lidhjes në skemën ekzistuese të rrjetit të shpërndarjes;
- vi) Vlerësimin e kostos së lidhjes për KSH, sipas variantit të lidhjes të propozuar nga ana e aplikantit;
- vii) Plotësimin e kushteve teknike të lidhjes;
- viii) Plotësimin e paragrafëve përkatës të Kodit të Shpërndarjes.

Në qoftë se pas analizës rezulton se lidhja do të jetë më mirë me tension të ndryshëm nga niveli i tensionit të propozuar nga aplikanti, atëherë lidhja do të bëhet në nivelin e tensionit përkatës të dalë nga studimi.

#### 4.3 Lidhja në rrjetin e shpërndarjes

Përdoruesi i sistemit të shpërndarjes që kërkon të lidhet me rrjetin e shpërndarjes ose që kërkon modifikimin e lidhjes ekzistuese, duhet të plotësojë kritere minimale teknike të, planifikimit dhe të operimit, me qëllim që të ruhet një operim i qëndrueshëm dhe i sigurt i sistemit të shpërndarjes. Kjo është gjithashtu e domosdoshme për mbrojtjen e centraleve dhe instalimeve të sistemit të shpërndarjes dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes të lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes.

##### 4.3.1 Kushtet e lidhjes me sistemin e shpërndarjes

Kushtet e lidhjes me sistemin e shpërndarjes vendosin parimet dhe standardet minimale lidhur me realizimin e lidhjes, metodës së lidhjes dhe standardeve teknike të lidhjes. Kushtet e lidhjes duhet të jenë të ngjashme për të gjithë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për kategoritë ekuivalente. Kushtet e lidhjes me sistemin e shpërndarjes specifikojnë informacionin që do të sigurohet nga përdoruesit e sistemit të shpërndarjes për të siguruar marrjen e masave të përshtatshme nga kompania(të) e shpërndarjes për lidhje të reja ose modifikime të lidhjeve ekzistuese.

Përdoruesit e ardhshëm të sistemit të shpërndarjes do t'i sigurojnë kompanisë(ve) së shpërndarjes në kohën e duhur gjithë informacionin dhe të dhënat e përcaktuara në këtë Kod. Kushtet e lidhjes shoqërohen nga marrëveshjet e lidhjes, që janë marrëveshje dypalëshe mes kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe çdo përdoruesi të sistemit të shpërndarjes, dhe që përmbajnë detaje specifike për lidhjen e çdo përdoruesi dhe përdorimin e sistemit të shpërndarjes. Marrëveshja e lidhjes kërkon që përdoruesi i sistemit të shpërndarjes dhe kompania(të) e shpërndarjes të plotësojnë dispozitat e Kodit të Shpërndarjes.

Kushtet e lidhjes përcaktojnë standardet minimale për metodën e lidhjes me sistemin e shpërndarjes dhe standardet teknike, të planifikimit dhe operative, që do të plotësojnë përdoruesit që lidhen me sistemin e shpërndarjes. Kushtet e lidhjes specifikojnë marrëveshjet teknike të kërkuara në kufijtë e pronësisë në mes të sistemit të shpërndarjes dhe instalimit të përdoruesit të sistemit të shpërndarjes dhe aplikimit të tij në gjitha nivelet e tensionit të rrjetit të shpërndarjes. Kushtet e lidhjes përmbledhin tipet e të dhënave dhe treguesit që do të kërkohen për t'u bërë të disponueshem për kompaninë(të) e shpërndarjes nga çdo përdorues i sistemit të shpërndarjes. Kushtet e lidhjes aplikohen nga të gjithë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes të lidhur që kërkojnë modifikimin e lidhjes ekzistuese, si dhe nga përdoruesit që planifikojnë të lidhen me sistemin e shpërndarjes.

##### 4.4 Marrëveshjet e lidhjes

Gjatë aplikimit për lidhje, kompania(të) e shpërndarjes, bazuar në studimin përkatës dhe në konsultim me aplikantin, do të specifikojë nivelin e tensionit në të cilin përdoruesi i sistemit të shpërndarjes do të lidhet sipas praktikave normale për tipin e ngarkesës që do të furnizohet dhe karakteristikat e rrjetit.

Niveli i tensionit do të jetë tensioni minimal i lejuar në përdorimin standard në sistemin e shpërndarjes. Bazuar në informacionin e dhënë nga përdoruesi në kompaninë(të) e shpërndarjes për lidhje në sistemin e shpërndarjes, kompania(të) e shpërndarjes do të përgatisë një raport që përmban elementet e mëposhtme që janë të nevojshme dhe të rëndësishme për lidhjen e propozuar:

- Tensionin nominal në të cilin do të bëhet lidhja.
- Metoda e lidhjes, detajet e zgjatimit dhe/ose përforsimit.
- Rënia e tensionit nga burimi në pikën e lidhjes.
- Metoda e tokëzimit.
- Kapaciteti maksimal i tërheqjes së energjisë elektrike.

Kufizimet individuale të klientit lidhur me:

- Deformimet e Harmonikave,
- Luhatjet e tensionit (Voltage Flicker),
- Mosbalancimin,
- Periudhën kohore të parashikuar për sigurimin e lidhjes (duke ndjekur pranimin normal të termave të furnizimit),
- Koston e lidhjes.

#### 4.5 Kufijtë e pronësisë

Pika ose pikat në të cilat energjia tërhiqet ose injektohet mes sistemit të shpërndarjes dhe instalimit të përdoruesit do të vendoset nga kompania(të) e shpërndarjes dhe përdoruesi sipas kërkesës. Kufijtë e pronësisë do të caktohen në marrëveshjen e lidhjes ose marrëveshjen e furnizimit me qellim që:

- të lehtësojnë veprimet e mirëmbajtjes së kompanisë(ve) së shpërndarjes;
- të minimizojnë shqetësimet e përdoruesit të sistemit të shpërndarjes nga kompania(të) e shpërndarjes dhe detyrat e përditshme të furnizuesit;
- të lehtësojnë leximet e matësve komerciale dhe transmetimin e të dhënave;
- të mundësojnë shkëputjen dhe rilidhjen e pajisjeve në rrjet.

Për furnizimet në tension të ulët përgjegjësia e kompanisë(ve) së shpërndarjes shtrihet deri në pikën e lidhjes së klientit. Për furnizimet në tension të lartë kufijtë e pronësisë do të jenë në çdo rast objekt i marrëveshjeve specifike mes palëve. Ndryshimet në marrëveshjet e kufijve të propozuara nga secila palë do të vendosen paraprakisht.

Gjithë pajisjet në kufijtë e pronësisë, do të plotësojnë parimet e planifikimit që përmbahen në kapitullin e planifikimit. Lidhjet e përdoruesve me sistemin e shpërndarjes do të përfshijnë mjete të shkëputjes së instalimit të përdoruesit nga sistemi i shpërndarjes.

#### 4.6 Kërkesat teknike për lidhje

Lidhja në sistemin e shpërndarjes mund të bëhet nëpërmjet një linje ajrore, një kabli nëntokësor ose një kombinim i të dyjave. Konfigurimi i rrjetit në pikën e lidhjes mund të kërkojë një numër formash të përshtatshme për natyrën e ngarkesës dhe rregullimet e rrjetit.

Gjitha pajisjet në një instalim të lidhur me sistemin e shpërndarjes do të planifikohen, ndërtohen, testohen dhe instalohen sipas të gjitha detyrimeve ligjore të aplikueshme dhe do të përshtaten me CENELEC (Komiteti Europian për Standardizimin Elektroteknik) ose standardet shqiptare deri në kohën e lidhjes së instalimit me sistemin e shpërndarjes. Kompania(të) e shpërndarjes mund të njoftojë përdoruesit e sistemit të shpërndarjes që duhet të plotësojnë specifikimet dhe/ose standardet shtesë.

Të gjitha pajisjet në një instalim të lidhur me sistemin e shpërndarjes do të jenë të përshtatshme për përdorim në frekuencën e operimit të sistemit të shpërndarjes dhe në tensionin dhe qarkun e shkurtër të sistemit të shpërndarjes në pikën e lidhjes, sipas kapitullit mbi planifikimin në kodin e shpërndarjes. Kompania(të) e shpërndarjes mund t'i kërkojë certifikatë prodhuesit që pajisja është e projektuar dhe e instaluar në mënyrë të pranueshme. Kompania(të) e shpërndarjes mund të kërkojë gjithashtu prova që pajisja është testuar sipas legjislacionit në fuqi dhe është përputhur me standardet ndërkombëtare.

Para nënshkrimit të një marrëveshjeje për lidhje, do të jetë e nevojshme që kompania(të) e shpërndarjes të bindet që sistemi i përdoruesit në kufijtë me sistemin e shpërndarjes të plotësojë kërkesat e duhura të Kodit të Shpërndarjes.

#### 4.6.1 Kërkesat e mbrojtjes

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes do të sigurojnë që gabimet në centralin dhe instalimet e përdoruesit të mos shkaktojnë shqetësime në sistemin e shpërndarjes ose për përdoruesit e tjerë. Pa kufizuar detyrimet e tij, përdoruesi para lidhjes së instalimit të përdoruesit në sistemin e shpërndarjes do të instalojë pajisjen e mbrojtjes.

Gabimet në sistemin e shpërndarjes mund të dëmtojnë centralin dhe instalimin e përdoruesit. Këto gabime mund të rezultojnë në humbje faze, mbi tension ose nën tension. Përdoruesi i sistemit të shpërndarjes do të marrë parasysh praktikatat e vendosura të rrjetit të veçantë në të cilin do të bëhet lidhja, si dhe do të sigurojë që mbrojtja e instaluar të përputhet me atë të përdorur nga kompania(të) e shpërndarjes. Përshtatja e mbrojtjes së instaluar nga përdoruesi i sistemit të shpërndarjes është përgjegjësi e përdoruesit.

Marrëveshjet e mbrojtjes së përdoruesit të sistemit të shpërndarjes në kufijtë e pronësisë, përfshirë tipet e pajisjes dhe pajisjet e mbrojtjes, do të përputhen me kushtet ekzistuese të sistemit të shpërndarjes dhe praktikatat e mbrojtjes së sistemit të shpërndarjes siç specifikohet nga kompania(të) e shpërndarjes në kohën e aplikimit.

Përdoruesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm që shpëputjet e vetëm një ose dy fazave të sistemit me tre faza mund të kushtëzohen nga marrëveshjet e mbrojtjes së shpërndarjes për disa lloje gabimesh. Mbrojtja minimale e kërkuar për një instalim të përdoruesit, të lidhur me sistemin e shpërndarjes, do të ndryshojë sipas tipit, përmasës, metodës së lidhjes dhe tokëzimit të sistemit të përdoruesit.

Lidhja e re kërkon si minimum mbrojtjet e mëposhtme:

- Mbi-rrymën trefazore
- Mbrojtjen nulare
- Të tjera të nevojshme sipas rastit konkret

Aty ku përdoren çelësa në kufijtë e pronësisë, ata do të përshtaten me rele të një tipi të pranueshëm për kompaninë(të) e shpërndarjes. Këto rele do të kenë elemente mbi-rrymë trefazore dhe një element për mbrojtjen nulare dhe do të kenë karakteristika kohë-rrymë. Vendosja e vlerave maksimale të lejueshme e releve në kufijtë e pronësisë, do të sigurohet nga kompania(të) e shpërndarjes dhe këto vlera mund të rishikohen në çdo kohë në të ardhmen nga kompania(të) e shpërndarjes.

Me qëllim që të sigurohet operimi i kënaqshëm i sistemit të shpërndarjes, në mes të kompanisë(ve) së shpërndarjes dhe përdoruesit të sistemit të shpërndarjes do të vendosen sisteme mbrojtjeje, kohët e operimit dhe ndjeshmëri në kufijtë e pronësisë gjatë aplikimit për procesin e lidhjes, dhe mund të rishikohen herë pas herë nga kompania(të) e shpërndarjes.

Për të shmangur efektet që vijnë nga mosfunksionimi i një çelësi ose pajisjeje tjetër do të sigurohet mbrojtje *back-up* (rezervë) sipas kërkesës së KSH-së. Reletë e mbrojtjes do të instalojnë nga përdoruesi i sistemit të shpërndarjes dhe duhet të jenë brenda kufijve teknikë të lejueshëm. Kompania(të) e shpërndarjes mund t'i testojë këto mbrojtje dhe do të jetë përgjegjësi e përdoruesit të sistemit të shpërndarjes që të njoftojë kompaninë(të) e shpërndarjes për testimin e këtyre pajisjeve. Përdoruesit do të sigurojnë që pajisjet e mbrojtjes të mbeten nën nivelet maksimale të lejuara.

#### 4.6.2 Tokëzimi

Tokëzimi i një pjese të instalimit të përdoruesit, që është i lidhur me sistemin e shpërndarjes, do të plotësojë kërkesat e Kodit të Shpërndarjes, si dhe legjisllacionit në fuqi. Instalimi i tokëzimit të sistemit të shpërndarjes, do të jetë konform rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Përdoruesi i sistemit të shpërndarjes do të ndërmarrë masa sigurie për të kufizuar shpeshësinë dhe efektet e rrymave qarkulluese lidhur me pikat neutrale të lidhura me tokën, atje ku ka më shumë se një burim energjie.

#### 4.6.3 Rregullimi dhe kontrolli i tensionit

Lidhjet me sistemin e shpërndarjes do të planifikohen në mënyrë që ato të mos pengojnë kontrollin e nevojshëm të tensionit në sistemin e shpërndarjes. Informacioni për rregullimin e tensionit dhe marrëveshjet e kontrollit do të paraqiten nga kompania(të) e shpërndarjes, nëse kërkohen nga përdoruesi i sistemit të shpërndarjes.

#### 4.6.4 Rryma e lidhjes së shkurtër

Vlerësimi i rrymës së lidhjes së shkurtër të pajisjes së përdoruesit në pikën e lidhjes nuk do të jetë më i ulët se niveli i projektuar i rrymës së lidhjes së shkurtër në sistemin e shpërndarjes. Rryma e furnizimit të përdoruesit të sistemit të shpërndarjes do të kontrollohet nga një çelës kryesor i qarkut që do të jetë në përputhje me një standard të njohur ndërkombëtar të kënaqshëm për kompaninë(të) e shpërndarjes.

#### 4.6.5 Nivelet e izolimit

Projektimi i një pajisjeje të lidhur me sistemin e shpërndarjes duhet të jetë i tillë që të mundësojë mbijetesën ndaj rrymës alternative (AC) dhe testeve të impulseve.

#### 4.6.6 Efektet kapacitive dhe induktive

Përdoruesi i sistemit të shpërndarjes do t'i sigurojë kompanisë(ve) së shpërndarjes informacion mbi çdo terësi kondensatorësh dhe reaktorësh të lidhur me tensionin e lartë dhe/ose tensionin e mesëm, që mund të ndikojë në sistemin e shpërndarjes.

#### 4.6.7 Çrregullimet e tensionit

Përdoruesit e sistemit të shpërndarjes nuk do të gjenerojnë çrregullime tensioni në një nivel që ndikon përdoruesit e tjerë të lidhur në sistemin e shpërndarjes. Përdoruesit duhet të zgjedhin pajisjet që janë në gjendje të funksionojnë në mënyrë të kënaqshme në prezencë të çrregullimeve në nivelet e lejuara nga standardet ndërkombëtare.

#### 4.6.8 Matja dhe telemetria

Përdoruesit mund t'i kërkohet të sigurojë tregues të tensionit, rrymës, frekuencës, energjisë elektrike aktive dhe reaktive të përmasave që janë esenciale për kompaninë(të) e shpërndarjes për të siguruar monitorimin e duhur të sistemit të shpërndarjes. Detajet do të specifikohen në marrëveshjen e lidhjes.

Nëse vendoset mes palëve që kompania(të) e shpërndarjes do të kontrollojë pajisjen kyçëse në sistemin e përdoruesit, atëherë ajo do ta instalojë stacionin e nevojshëm të telekontrollit. Përgjegjësia e përdoruesit të sistemit të shpërndarjes është të sigurojë ndërhyrjen e nevojshme për kontrollin e pajisjeve kyçëse të tijat që duhen kontrolluar.

Personeli që kryen punën projektuese ose instaluese për shkëmbimin klient/ me kompaninë(të) e shpërndarjes duhet të ndjekë parimet e Kodit të Shpërndarjes.

#### 4.6.9 Rregullat specifike për gjeneruesit e lidhur me sistemin e shpërndarjes

Integriteti i sistemit të shpërndarjes, si dhe siguria dhe cilësia e furnizimit të përdoruesve ekzistues të sistemit të shpërndarjes nuk duhet të bjerë nën standarde si rezultat i gjeneruesve që operojnë të sinkronizuar me sistemin e shpërndarjes. Kushtet për operim do të garantojnë sigurinë e:

- publikut të gjerë;
- personelit;
- pajisjeve të sistemit të shpërndarjes dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes.

Njësitë gjeneruese të lidhura me sistemin e shpërndarjes dhe që operojnë në paralel ose që janë të afta të operohen në paralel me sistemin e shpërndarjes do të plotësojnë kërkesat për lidhje të gjeneruesve të shpërndarjes. Ky Kod cakton kushtet që do të plotësojnë njësitë gjeneruese që operojnë në paralel në sistemin e shpërndarjes. Gjeneruesi i lidhur me sistemin e shpërndarjes është përgjegjës për mbrojtjen e personelit të tij dhe pajisjeve dhe operimin eficient të njësisë së tij gjeneruese.

Kompania(të) e shpërndarjes do të informohet se ku do të instalohet një njësi gjeneruese. Kompania(të) e shpërndarjes do të ketë të drejtën të inspektojë instalimet gjeneruese për të siguruar që janë plotësuar kërkesat. Në disa raste kompania(të) e shpërndarjes mund të kërkojë një demonstrim ose testim të operimit të gjeneruesit. Këto demonstrime dhe teste do të bëhen sipas marrëveshjes me gjeneruesin.

#### 4.7 Sigurimi i informacionit

Informacioni i kërkuar nga kompania(të) e shpërndarjes para hyrjes në një marrëveshje për të lidhur çdo central gjenerues në sistemin e shpërndarjes është si më poshtë: Njësitë gjeneruese.

##### a) Parametrat e gjeneratorëve

1. Tensioni nominal ( $U_n$  në kV)
2. Fuqia e plotë nominale ( $S_n$  në MVA)
3. Fuqia aktive nominale ( $P_n$  në MW)
4. Rryma nominale e fazës ( $I_n$  në A)
5. Faktori i fuqisë nominale ( $\cos \varphi$ )
6. Frekuenca nominale ( $F_n$  në Hz)
7. Shpejtësia nominale ( $N_n$  në rrot/min)
8. Konstantja e inercisë H (MW Sec/MVA)
9. Momenti volantit ( $GD^2$  në  $Tm^2$ )
10. Koeficienti i lidhjes së shkurtër ( $K_c$ )
11. Reaktanca sinkrone gjatësore ( $X_d$  në p.u)
12. Reaktanca kalimtare gjatësore ( $X'd$  në p.u)
13. Reaktanca superkalimtare gjatësore ( $X''d$  në p.u)
14. Reaktanca sinkrone tërthore ( $X_q$  në p.u)
15. Reaktanca kalimtare tërthore ( $X'q$  në p.u)
16. Reaktanca superkalimtare tërthore ( $X''q$  në p.u)
17. Rezistenca e statorit për fazë në  $75^\circ C$  ( $R_a$  në om)
18. Konstantja e kohës kalimtare gjatësore për përshtjellë të statorit të hapur ( $T'_{do}$  në sek).
19. Konstantja e kohës superkalimtare sipas aksit gjatësor për përshtjellë statori të hapur

( $T''_{do}$  në sek).

20. Konstantja e kohës kalimtare tërthore për qark të hapur ( $T'_{qo}$  në sek).
21. Konstantja e kohës superkalimtare tërthore për qark të hapur ( $T''_{qo}$  në sek).
22. Konstantja e kohës e përshtjellës së statorit të lidhur në të shkurtër ( $T_s$  në sek)
23. Kurba e ngopjes së qarkut të hapur
24. Kurba e aftësisë së gjeneratorit

##### b) Parametrat e sistemit të eksitimit dhe rregullatorit automatik të tensionit (RAT)

1. Tipi i eksituesit
2. Rryma nominale e punës së eksituesit ( $I_n$  në A)
3. Tensioni nominal i punës së eksituesit ( $U$  në V)
4. Rryma maksimale e eksituesit gjatë kohës kalimtare ( $I_{max}$  në A)
5. Tensioni maksimal i eksituesit ( $U_{max}$  në V)
6. Përgjigjja kalimtare e sistemit të eksitimit
7. Karakteristika e përgjigjes së sistemit të eksitimit me lak të hapur
8. Karakteristika e përgjigjes së sistemit të eksitimit me lak të mbyllur
9. Karakteristika dinamike të mbiëksitimit dhe kufijtë
10. Karakteristika dinamike të nën eksitimit dhe kufijtë
11. Skema strukturore e detajuar e të gjithë sistemit të eksitimit, ku tregohen në detaje funksionet transmetuese të elementeve të tij dhe parametrat e elementeve transmetuese.

$K_A$  - Konstante e rregullatorit të tensionit

$T_A$  - Konstante kohë e rregullatorit të tensionit

$V_R \max.$  - Tensioni normal Max në dalje

$V_A \max, V_A \min$  - tensioni maksimal dhe minimal i rregullatorit të brendshëm

##### C) Parametrat e rregullimit dhe rregullatorët e shpejtësisë

1. Tipi i rregullatorit të shpejtësisë
2. Koeficienti kg i përcaktimit të shkallës së futjes në punë të rregullatorit të shpejtësisë ( në MW/Hz) siç përcaktohet në normat IEEE.

3. Dhënia e shpejtësisë dhe konstantja e kohës e tij ( $T_{SR}$ )
4. Konstante e kohës së servomotorit dhe aparatit drejtues ( $T_{SM}$ )
5. Valvula e hapjes së rregullatorit të shpejtësisë me numër limit ( $CV_{.OPEN}$ )
6. Valvula e mbylljes me numër limit e rregullatorit të shpejtësisë ( $CV_{.CLOSE}$ )
7. Kufiri i valvulës së rregullatorit të shpejtësisë ( $CV_{Max.}$  dhe  $CV_{min}$  )
8. Bazuar në sistemin e turbinave me avull në CR-IEEE parametrat e mëposhtëm duhet të sigurohen këtu ku është e përshtatshme.

i)  $T_{RH}$ ,  $T_{RH1}$  - Konstante kohë e ritejnxehjes (stadi i parë)

ii)  $T_{RH2}$  - Konstante kohë e ritejnxehjes (stadi i dytë)

9. Skema strukturore e sistemit të rregullimit dhe rregullatorit të shpejtësisë duke treguar funksionet transmetuese të elementeve të veçantë .

Parametrat e transformatorëve në njësitë gjeneruese:

- a) Fuqia nominale MVA
- b) Tensioni nominal kV
- c) Grupi i lidhjes
- d) Humbjet në ngarkesë  $P_{cu}$  në kW
- e) Tensioni i lidhjes së shkurtër  $U_k$  në %
- f) Humbjet pa ngarkesë  $P_o$  në kW
- g) Rryma e punimit pa ngarkesë  $I_o$  në %
- h) Reaktanca e renditjes së drejtë (për pozicionet në maksimum, minimum dhe normal të ancafkave) (% të MVA)
- i) Rezistenca e renditjes së drejtë (për pozicionet në maksimum, minimum dhe normal të ancafkave) (% të MVA)
- j) Reaktanca e renditjes nulare (% të MVA)
- k) Niveli i rregullimit të tensionit ( $\pm\%$ ) dhe hapat
- l) Tipi i rregullimit të tensionit (off-load/on-load)

#### 4.8 Marrëveshjet në kufijtë

Në marrëveshjet në kufijtë përcaktohen detaje për lidhjen me tokën e pajisjeve të centraleve gjeneruese, të lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes, si dhe specifikime të ndryshme që mund të kërkojnë sipas rasteve konkrete të lidhjes së njësisë gjeneruese me sistemin e shpërndarjes. Detajet e informacionit të kërkuar do të ndryshojnë në varësi të tipit dhe fuqisë së njësisë së gjenerimit ose pikës ku është bërë lidhja me sistemin e shpërndarjes. Informacioni do të sigurohet nga gjeneruesi me kërkesën e arsyeshme të kompanisë(ve) së shpërndarjes.

KSH do ta përdorë informacionin e siguruar për të modeluar njësinë e gjenerimit për të përcaktuar një metodë teknikisht të pranueshme të lidhjes. Nëse KSH konkludon në mënyrë të arsyeshme se natyra e lidhjes së propozuar ose ndryshimet në një lidhje ekzistuese kërkon analiza më të detajuara, atëherë mund të kërkojë informacion i mëtejshëm i specifikuar.

Në rrethana normale informacioni i specifikuar më lart do ta mundësojë kompaninë(të) e shpërndarjes të vlerësojë kërkesat e lidhjes. Me raste mund të kërkojë informacion shtesë. Në këto rrethana, informacioni do të bëhet i disponueshëm nga gjeneruesit e lidhur me sistemin e shpërndarjes, me kërkesën e arsyeshme të kompanisë(ve) së shpërndarjes.

Informacioni i siguruar nga kompania(të) e shpërndarjes

Kompania(të) e shpërndarjes do të përgatisë një raport për gjeneruesit që aplikojnë për lidhje me sistemin e shpërndarjes. Në rastet kur sigurohet eksporti i energjisë elektrike do të jepet informacioni i mëposhtëm shtesë:

- Pajisjet e mbrojtjes në kufij,

- Pajisjet, kabllot, çelësat dhe kërkesat e matjes,

- Vendi i stacionit dhe kërkesat e ndërtimit (përmasat, aksesi, leja e planifikimit, tokezimi, ndriçimi dhe ngrohja).

#### 4.9 Kërkesat e performancës së centralit gjenerues të shpërndarë

Për gjeneruesit e lidhur me sistemin e shpërndarjes që nuk janë objekt i dispeçerimit qendror, parametrat elektrikë që duhen arritur në terminalet e njësive së gjenerimit, do të specifikohen nga kompania(të) e shpërndarjes me ofertën për lidhje. Mbrojtja e centralit gjenerues, të lidhur në sistemin e shpërndarjes, do të kërkohet të koordinohet me mbrojtjen e sistemit të shpërndarjes për:

- Periudhën e lejueshme për rrymat e gabuara;
- Koordinimin me kërkesat e vetë rikyçjes;
- Pajisjet mbrojtëse të çelësit kontrollues.

Pajisjet e mbrojtjes nuk do të ndryshohen pa marrëveshje me kompaninë(të) e shpërndarjes. Kufiri për luhatjet e tensionit dhe të shkaktuara nga kyçja ose operimi i vazhdueshëm i instalimeve të turbinave me erë ose të ndonjë tipi tjetër është  $P_{st} = 0.35$  dhe  $P_{lt} = 0.35$  ku:

$P_{st}$ : Shpeshtësia (intensiteti) e luhatjes afatshkurtër – një indeks i shpeshtësisë vizuale të vlerësuar gjatë një periudhe prej 10 minutash.

$P_{lt}$ : Shpeshtësia e luhatjes afatgjatë – një indeks i shpeshtësisë vizuale të vlerësuar për një periudhë 2 orëshe.

Për gjeneruesit, shtrembërimi i harmonikave të tensionit në varësi të nivelit të tensionit e shprehur në (%) është:

- 0,4 kV = 2.5
- 10 kV = 2.0
- 20 kV = 2.0
- 35 kV = 1.5

Një program i kufijve individualë të shtrembërimit harmonik do të sigurohet nga kompania(të) e shpërndarjes kur është e përshtatshme.

#### 4.10 Punimi në ishull

Është e mundur që një pjesë e sistemit të shpërndarjes në të cilin janë të lidhur gjeneruesit, gjatë kushteve të emergjencës të shkëputet nga pjesa tjetër e sistemit. Kompania(të) e shpërndarjes mund të vendosë, në varësi të kushteve të rrjetit lokal, nëse është e dëshirueshme për gjeneruesit e lidhur me sistemin e shpërndarjes, që të vazhdojë të gjenerojnë në seksionin e ndarë të sistemit të shpërndarjes.

Nëse nuk ekzistojnë facilitete për risinkronizimin e mëtejshëm me pjesën tjetër të sistemit të shpërndarjes, atëherë gjeneruesi i lidhur me sistemin e shpërndarjes, sipas udhëzimeve të kompanisë(ve) së shpërndarjes, do të sigurojë që centrali gjenerues është shkëputur për risinkronizim.

Në kushtet e emergjencës ka të ngjarë që disa gjenerues të vazhdojnë të operojnë jashtë kufijve të lejuar të frekuencës. Megjithatë, për gjeneruesit e lidhur me sistemin e shpërndarjes ka të ngjarë që kjo do të thotë lidhje me një zonë shkëputje automatike të ngarkesës me frekuencë të ulët. Gjeneruesi, i lidhur me sistemin e shpërndarjes duhet të ketë pajisje mbrojtjeje për të koordinuar me pajisjen e shkëputjes me frekuencë të ulët që do të detajohet nga kompania(të) e shpërndarjes me kërkesë.

##### 4.10.1 Aftësia black start (ristartuese)

Gjeneruesi, i lidhur me sistemin e shpërndarjes, do të njoftojë KSH-në nëse centrali i tij gjenerues ka aftësi ristartuese pa lidhje me një furnizim të jashtëm energjie, përveçse kur gjeneruesi ka njoftuar më parë operatorin e sistemit të transmetimit sipas Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

##### 4.10.2 Testet e komisionimit të centraleve gjenerues

Kur centrali gjenerues kërkon lidhjen me sistemin e shpërndarjes përpara datës së komisionimit për qëllime testimi, gjeneruesi do të plotësojë kërkesat e marrëveshjes së lidhjes.

Gjeneruesi do t'i sigurojë kompanisë(ve) së shpërndarjes një program komisionimi të miratuar më pas nga kompania(të) e shpërndarjes për të lejuar koordinimin e testeve të komisionimit.

#### 4.10.3 Gjeneratorët rezervë (stand by)

Operimi paralel me sistemin e shpërndarjes zakonisht nuk lejohet për gjeneratorët rezervë. Për operimin paralel kërkohet marrëveshja specifike me kompaninë(të) e shpërndarjes.

Klientët me gjenerim rezervë do të sigurojnë që çdo pjesë e instalimit, të furnizuar nga centrali i gjenerimit, të jetë shkëputur që në fillim nga sistemi i shpërndarjes dhe të mbetet i shkëputur ndërkohë që centrali i gjenerimit lidhet me instalimin. Metodat e shkëmbimit dhe të lidhjes do të plotësojnë kërkesat shtesë për instalimet e gjeneratorëve sinkrone me tension të ulët.

## KAPITULLI V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

5.1 Kodi i Funkcionimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është objekt rishikimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

5.2 Ky Kod hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI:**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004**  
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004**

Doli nga shtypi më 15.9.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë